

GJYKATËS THEMELORE TË PRISHTINËS
DEPARTAMENTIT PËR ÇËSHTJE EKONOMIKE
DIVIZIONIT PËR INVESTITORË TË HUAJ

Paditëse: **Federata Sindikale e Pavarur e PTK-së («Sindikata»)**
Lagjja Dardania p.n., 10010 Prishtinë
përfaqësuar nga juristët Getoar Mjeku e Blerim Sallahu

i paditur: **DARDAFON.net L.L.C. («Z Mobile»)**
Rr. Dëshmori p.n., Miradi e Epërme, 12010 Fushë-Kosovë

e interesuar: **Telekomi i Kosovës, SH.A. («Telekomi»)**
Lagjja Dardania p.n., 10010 Prishtinë

**PADI PËR VËRTETIMIN E NULITETIT
DHE KËRKESË PËR MASA TË SIGURIMIT**

baza juridike: Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve, nenet 89–96
Ligji mbi marrëdhëniet e detyrimeve 1978, nenet 103–110
Ligji për procedurën kontestimore, nenet 297–307

akti i goditur: Marrëveshje e mbështetjes e operatorit të rrjetit mobil virtual, lidhur mes të paditurit dhe Telekomit të Kosovës, më 16 janar 2009

për shkak se: Akti cenon rendin publik, dispozitat urdhëruese dhe moralin e shoqërisë

Prishtinë, 17 korrik 2020

Përfaqësuesit e paditëses:

Dr. Getoar Mjeku | Blerim Sallahu
Rr. Enver Maloku nr. 110, 10000 Prishtinë
+383 45 305 200 | gm@getoar.com
+383 44 765 980 | blerimsallahu@gmail.com

Përmbajtja

I. HYRJE.....	3
A. Përmbledhje.....	3
B. Baza juridike.....	5
C. Shkurtesa.....	6
II. PROVAT.....	7
III. ARSYETIMI JURIDIK.....	11
A. Juridiksioni i Departamentit Ekonomik.....	11
B. Lejueshmëria e padisë.....	12
C. Propozim rreth legjitimitetit të paditëses.....	14
IV. FAKTET.....	15
A. Palët.....	15
B. Marrëveshja.....	16
C. 2007–2012: Negociatat dhe problemet e hershme.....	16
D. 2013–2016: Procedurat vendore dhe arbitrazhi ndërkombëtar.....	23
E. 2017–2020: Veprimet pas arbitrazhit dhe problemet e reja.....	25
F. Epilogu i Marrëveshjes.....	30
V. SHKELJET LIGJORE.....	34
A. Baza ligjore për nulitetin.....	34
B. Marrëveshja cenon parimet kushtetuese mbi rendin ekonomik.....	38
C. Marrëveshja lejon dënime të shumëfishta kontraktore — masë plaçkitëse në kundërshtim me vendimet e Kushtetueses e Supremes dhe dispozitat urdhëruese të LMD-së.....	40
D. Marrëveshja cenon dispozitat urdhëruese dhe moralin, duke lejuar sjellje jolegjitime ndaj palës dhe komunitetit.....	43
VI. DËMET.....	45
A. Baza ligjore.....	45
B. Llogaritja.....	45
VII. MASAT E SIGURIMIT.....	47
A. Baza ligjore.....	47
B. Arsyetimi.....	49
C. Shuma e siguruar.....	51
D. Kërkesa për aktvendim.....	52
VIII. KËRKESËPADIA.....	54

I. HYRJE

A. Përmbledhje

1. Ndërmarrja publike Telekomit i Kosovës dhe kompania private DAR-DAFON.net (Z Mobile) kanë nënshkruar Marrëveshjen e mbështetjes e operatorit të rrjetit mobil virtual, më 2009. Marrëveshja e quan Z Mobilen operator virtual dhe i mundëson ta shfrytëzojë infrastrukturën e Telekomit, operator amë, për të ofruar shërbime të telefonisë mobile.
2. Marrëveshja ia ka siguruar Z Mobiles platformën e operatorit amë për çmim shumëfish më të ulët se kontratat e rrjeteve virtuale nëpër botë. Ekspertët Z Mobilen madje s'e konsiderojnë fare operator virtual, por rishitës pa platformë të veten. Marrëveshja i ka dhënë Telekomit vetëm 27 për qind të të ardhurave që deklaron Z Mobile, kurse Z Mobile ka mbajtur shumicën dërrmuese dhe nuk ka mbuluar kostot e mirëmbajtjes. Disa vjet, nuk ka paguar as 27-përqindëshin.
3. Tutje, Marrëveshja i ka dhënë Z Mobiles qasje të pakufizuar në numra e kartela telefoni e në rrjetin 3G/4G, ndërsa ka detyruar Telekomit të përmbushë detyrime dhe të paguajë mes të tjerash ndëshkime për mospërmbushje dhe vonesë të mospërmbushjes.
4. Figurativisht, *Telekomi është bërë fabrikë që ka falur mallin e vet, ndërsa Z Mobile e ka shitur atë nën çmim, para dyerve të fabrikës. Siç thotë reklama e Z Mobiles, «ofertën më të mirë në botë, na ta shkelim me rrotë».* Duke shitur shërbime nën kosto, Z Mobile ka mbingarkuar rrjetin, dëmtuar tregun dhe rënduar cilësinë e telekomunikacionit në vend. Vetëm dëmet e Telekomit kalojnë shumë 263 milionë euro, duke llogaritur dëmin e rëndomtë dhe fitimin e humbur.
5. Humbjet kanë nisur me Marrëveshjen më 2009, por është e pasigurt nëse do të përfundojnë dhe kur. Më 30 korrik, Telekomit ka njoftuar se Marrëveshja ka skaduar, dhe në nëntor ka marrë përsipër ish-klientët e Z Mobiles. Por Z Mobile këmbëngul se Marrëveshja është ende në fuqi, dhe ka nisur procedurë për ta rikthyer Marrëveshjen edhe për pesë a më shumë vjet.

Padia për vërtetimin e nulitetit

6. Kështu Marrëveshja është ligjërish e pavlefshme. Sipas ligjit, një kontratë është nule nëse cenon rendin publik, dispozitat urdhëruese ose moralin e shoqërisë.¹ Marrëveshja Telekomit–Z Mobile është e pavlefshme për tri shkaqe kryesore: Së pari, shkel parimet kushtetuese. Së dyti, bie ndesh me jurisprudencën kushtetuese dhe dispozitat urdhëruese të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve. Dhe së treti, mundëson sjellje të pandërgjegjshme ndaj palëve të treta.
7. Veçanërisht, Marrëveshja shkel parimet ekonomike kushtetuese që garantojnë mirëqenien e qytetarëve, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, mirëmenaxhimin e ndërmarrjeve publike, si dhe konkurrencën e lirë dhe mbrojtjen e konsumatorëve.²
8. Njëherësh, Marrëveshja shkel vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Supreme si dhe Ligjin për marrëdhëniet e detyrimeve që nuk lejojnë shumëfishimin e ndëshkimeve kontraktore: lejohet ose penalltia për vonesë ose shpërblimi për mospërbushje, por jo të dyja.³
9. Përfundimisht, Marrëveshja shkel rendin publik dhe moralin e shoqërisë, duke stërngarkuar rrjetin e telekomunikacionit dhe duke penguar padrejtësisht konkurrencën dhe dëmtuar konsumatorët. Burimet e telekomunikacionit nuk janë të pakufishme, kurse Z Mobile falë Marrëveshjes i trajton si të tilla.
10. Ligji lejon palët e interesuara të ngrenë padi për ta vërtetuar pavlefshmërinë e një kontrate.⁴ Andaj Sindikata, si mbrojtëse e interesave të punëtorëve të Telekomit, po parashton këtë padi për vërtetimin e nulitetit, duke kërkuar njëherësh dhe kompensimin e dëmit.

Kërkesa për masa të sigurimit

11. Paditësja gjithashtu i propozon Gjykatës së nderuar **të caktojë menjëherë** masa të sigurimit për të parandaluar dëmet e mëtejme.

1 LMD, neni 89.

2 Kusht., neni 119.

3 Rasti *Raiffeisen*, KI 118/14, GjK, Aktvendim 9.3.2015 (vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjyk. E. Rev. nr. 24/2013, GjS, 5.2.2014); LMD, nenet 106, 137, 259–260; LMDJ, nenet 275–276.

4 LMD, neni 95.

12. Në veçanti, Sindikata kërkon prej Gjykatës:
- (1) t'ia ndalojë Z Mobiles të kërkojë ose pranojë përbushje të detyrimeve nga Telekomit ose aksionari i Telekomit;
 - (2) t'ia ndalojë Z Mobiles tjetërsimin ose fshehjen e pasurisë, për të siguruar të hollat për dëmshpërblim; dhe
 - (3) t'ua ndalojë Telekomit dhe Z Mobiles të lidhin kontratë të re ose të vazhdojnë Marrëveshjen përtej 30 korrikut 2019.
13. Për shkak të rrezikut që i kanoset vetë mbijetesës së Telekomit dhe sigurisë shtetërore të ndërlidhur me telekomunikacionin, është e domosdoshme që këto ndalesa të vihen si masa të përkohshme që tash, pa u njoftuar dhe dëgjuar palët.

B. Baza juridike

14. Paditësja mbështet padinë dhe kërkesën për masa të sigurimit në këto ligje, të cituara me shkurtesat ose nistoret:

Kusht. — Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në fuqi më 2008, ndryshuar së fundmi më 2016

LMD — Ligj 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, GZRK 16/2012, në fuqi 20 dhjetor 2012

LMDJ — Ligji mbi marrëdhëniet e detyrimeve i Jugosllavisë, GZ RSFJ 29/78, 39/85, 57/89, në fuqi 1 tetor 1978–19 dhjetor 2012

LPK — Ligji 03/L-006 për procedurën kontestimore, GZRK 38/2008, ndryshuar me ligjin 04/L-118, GZRK 28/2012

LNP — Ligj 03/L-087 për ndërmarrjet publike, GZRK 31/2008, ndryshuar me ligjin 04/L-111, GZRK 13/2012, në fuqi 15 qershor 2012; ligjin 05/L-009, GZRK 10/2015, në fuqi 7 maj 2015; dhe Ligjin 06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike, GZRK 3/2018, në fuqi 4 maj 2018

LGj — Ligji 06/L-054 për gjykatat, GZRK 22/2018

LH — Ligji 04/L-220 për investimet e huaja, GZRK 1/2014

C. Shkurtesa

15. Nistoret dhe shkurtesat e përdorura në këtë padi kanë këto kuptime:

GjK — Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës

GjS — Gjykata Supreme e Kosovës

GjThP — Gjykata Themelore e Prishtinës

DE — Departamenti për Çështje Ekonomike

DA — Departamenti për Çështje Administrative

ARBK — Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve e Kosovës

ARKEP — Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare i Republikës së Kosovës, më parë Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit (ART)

ICC — *International Chamber of Commerce* (Oda Ndërkombëtare e Tregtisë)

GZ — Gazeta Zyrtare

GZRK — Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës

II. PROVAT

16. Sindikata mbështet padinë në prova dokumente, të cilat i bashkëngjet si shtojca dhe i paraqet në format elektronik në një kompakt-disk (CD). Shtojcat janë të numëruara si vijon:

Kontrata

- Shtojca 1 Marrëveshje e mbështetjes e operatorit të rrjetit mobil virtual, lidhur mes Telekomit dhe të paditurit, më 16 janar 2009, shqip dhe anglisht («**Marrëveshja**»)
- Shtojca 2 Marrëveshje për ekzekutimin e vendimit final të arbitrazhit i nr. 20990/MHM, datës 09.12.2016, lidhur mes Telekomit dhe të paditurit, më 24 maj 2017 (tutje «**Ujdia jashtëgjyqësore**»)

Ekstrakte të të dhënave nga regjistra publikë

- Shtojca 3 Ekstrakt i të dhënave për shoqërinë Telekom i Kosovës SH.A., nga ARBK, bit.ly/2C0PXbf, 28 korrik 2019
- Shtojca 4 Ekstrakt i të dhënave për shoqërinë DARDAFON.net L.L.C., nga ARBK, bit.ly/2OpfXi, 28 korrik 2019
- Shtojca 5 Ekstrakt i të dhënave për shoqërinë Dardafon L.L.C., nga ARBK, bit.ly/3j1JmxK, 28 korrik 2019

Shkresa të organeve administrative

- Shtojca 6 Vendim nr. 381, ARKEP, 18 korrik 2013
- Shtojca 7 Raporti i auditimit të ndërmarrjes publike «Telekomi i Kosovës» për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2018, nga Zyra Kombëtare e Auditimit, qershor 2019, bit.ly/38UD2mY (tutje «**Auditimi 2018**»)
- Shtojca 8 Publikim nr. 02/2019 i ARKEP-it, Pasqyrë e tregut të komunikimeve elektronike për TM1, qershor 2019, bit.ly/30c4SY9
- Shtojca 9 Regjistri i Njoftimit në ARKEP, përditësuar më 5 qershor 2018, bit.ly/38Wm9It, qasur më 26 korrik 2019

Shtojca 10 Regjistri i ndërmarrjeve të licencuara nga ART-i, përditësuar më 21.11.2012, në sajtin e ARKEP-it, bit.ly/3gPj0x4, qasur më 26 korrik 2019

Shkresa të organeve të drejtësisë

Rasti A. nr. 1092/13, GjThP-DA:

Shtojca 11 Padia e 16 gusht 2013, ndaj vendimit nr. 381 të ARKEP-it

Shtojca 12 Parashtresë e 16 gusht 2013 për rregullimin dhe plotësimin e padisë ndaj vendimit nr. 381 të ARKEP-it

Rasti 20990/MHM, tribunali ICC:

Shtojca 13 *Claimant's Statement of Claim* [Padi], 29 janar 2016, anglisht

Shtojca 14 *Statement of Defense* [Përgjigje], 29 prill 2016, anglisht

Shtojca 15 Vendimi i pjesshëm i arbitrazhit i 21 nëntor 2016, anglisht dhe përkthimi shqip

Shtojca 16 Vendimi përfundimtar i arbitrazhit i 9 dhjetor 2016, anglisht dhe përkthimi shqip

Rasti II.EK. nr. 20/17, GjThP-DE

Shtojca 17 Padia e 19 janarit 2017, për anulimin e vendimit të arbitrazhit

Rasti KMLA nr. 1/17, GjS:

Shtojca 18 Propozimi i Telekomit për mbrojtjen e ligjshmërisë, drejtuar Prokurorit të Shtetit, më 19 janar 2017

Shtojca 19 Kërkesa e Prokurorit të Shtetit për mbrojtjen e ligjshmërisë e 26 janarit 2017

Rasti IV.V.C. nr. 118/17, GjThP-DE:

Shtojca 20 Propozimi i Z Mobiles i 7 marsit 2017

Shtojca 21 Kundërshtimi i Telekomit i 11 prillit 2017

Shtojca 22 Procesverbali mbi seancën dëgjimore të 19 majit 2017

Rasti IV.C. nr. 388/18, GjThP-DE:

- Shtojca 23 Propozimi i Z Mobiles i 16 korrikut 2018, pranuar nga Telekomit më 2 tetor 2018
- Shtojca 24 Kundërshtimi i Telekomit i 8 tetorit 2018
- Shtojca 25 Përgjigjja e Z Mobiles e 29 tetorit 2018 në kundërshtimin e Telekomit
- Shtojca 26 Kërkesa e Telekomit për seancë të shqyrtimit kryesor e 6 nëntorit 2018
- Shtojca 27 Aktvendimi i 11 shkurtit 2019

Rasti 24841/MHM/HBH, tribunali ICC:

- Shtojca 28 *Communication No. 4* [Komunikim nr. 4], 25 shkurt 2020, me bashkëngjitjet *Draft Procedural Order No. 1* [Draft-urdhër procedural nr. 1] dhe *Draft Terms of Reference* [Drafti i termave të referencës], anglisht

Rasti PPP. nr. 1486/2019, GjThP-DP:

- Shtojca 29 Aktvendimi i 6 korrikut 2020

Letërkëmbime dhe shkresa të tjera

- Shtojca 30 Marrëveshje për mbështetje ndërmjet PTK, Sh.A. dhe DARDAFONE, L.L.C., 8 tetor 2008, versioni anglisht, me komente (tutje «**Draftmarrëveshja anglisht**»)
- Shtojca 31 Marrëveshje për mbështetje ndërmjet PTK, Sh.A. dhe DARDAFONE, L.L.C., 8 tetor 2008, versioni shqip, me komente (tutje «**Draftmarrëveshja shqip**»)
- Shtojca 32 Dokumenti i Bordit të Drejtorëve të PTK-së, [Mendimi i ekspertëve të grupit të dytë punues], 20 tetor 2008
- Shtojca 33 Procesverbali i mbledhjes nr. 15 të Bordit të Drejtorëve të PTK-së, 20 tetor 2008
- Shtojca 34 Shkresë nga Monaco Telecom, 20 shtator 2010, në lidhje me mashtrimet *sim-to-sim*, anglisht

- Shtojca 35 Mendimi i ekspertit nga Analysis Maison, 2012, anglisht
- Shtojca 36 Shkresë nga Z Mobile, «Njoftim për shkëputjen e kontratës», drejtuar Bordit të Drejtorëve të Telekomit, nr. prot. 01-1562/18, 27 prill 2018
- Shtojca 37 Shkresë nga Telekomit, «Përgjigje në Njoftimin e datës 27.04.2018 dhe në Kërkesën tuaj të datës 22.06.2018», drejtuar Z Mobiles, nr. prot. 01-2546/18, 29 qershor 2018
- Shtojca 38 Shkresë nga Telekomit, «Njoftim», drejtuar Z Mobiles, nr. prot. 01-3561/19, 24 qershor 2019
- Shtojca 39 Departamenti Teknik [i Telekomit], Raporti mbi humbjet financiare dhe dëmet teknike të shkaktuara nga kontrata ndërmjet Telekomit të Kosovës dhe Z Mobile, qershor 2019, 30 faqe (tutje «**Raporti i dëmeve**»)
- Shtojca 40 Departamenti Teknik [i Telekomit], Raporti mbi humbjet financiare dhe dëmet teknike të shkaktuara nga kontrata ndërmjet Telekomit të Kosovës dhe Z Mobile, qershor 2019, 37 faqe, prezantim me sllajde (tutje «**Prezantimi i dëmeve**»)

Botime të ndryshme

- Shtojca 41 Raport i organizatës Çohu: L. Bajrami etj., *PTK: Nga agimi deri në muzg* (Prishtinë, 2015), bit.ly/3fFJMHS
- Shtojca 42 Pamje ekrani nga videoreklama «Z Mobile - Pako për Fundvit - Pako PA LIMIT - Commercial», punuar nga Karrota, 3 dhjetor 2018, youtu.be/JG6ByBA9vVM
- Shtojca 43 Albiona Ahmeti, «Me 30 korrik Telekomit mund të çlirohet nga Devollët: A do të ketë kontratë tjetër?», *Gazeta Express*, 26 qershor 2019, bit.ly/3frDGe5, përfshin kopje të shkresës nga Telekomit, cekur sipër te Shtojca 38
- Shtojca 44 Valon Fana, «Devollët dërgojnë te përmbaruesi Telekomit e Kosovës për 25 milionë euro», *Kallxo.com*, 15 korrik 2019, bit.ly/3gWfP6F

III. ARSYETIMI JURIDIK

A. Juridiksioni i Departamentit Ekonomik

Departamenti Ekonomik

17. Ligji për gjykatat parasheh që Departamenti për Çështje Ekonomike të ketë tagër mbi çështjet ekonomike dhe kontestet mes shoqërive tregtare.⁵ Departamenti Ekonomik i Gjykatës Themelore të Prishtinës ka juridiksion mbi mbarë vendin.⁶
18. Ndonëse paditësja nuk është shoqëri tregtare, padia për nga natyra i përket rrafshit ekonomik. Gjithashtu, objekti i shqyrtimit mund të lindë nga kontesti mes shoqërive tregtare — ose të kthehet në kontest mes dy bizneseve. Rrjedhimisht, Departamenti Ekonomik duhet ta zhvillojë gjyqin për këtë rast.

Divizioni për investitorët e huaj

19. Sipas Ligjit për gjykatat, brenda Departamentit Ekonomik vepron «Divizioni për kontestet lidhur me investitorë të huaj».⁷ Meqë Ligji për gjykatat nuk përkufizon investitorin, mbështetemi në Ligjin për investimet e huaja.
20. Në bazë të këtij ligji të posaçëm, investitor i huaj është, ndër të tjerë, personi i huaj që investon në Kosovë,⁸ përfshi personin juridik të themeluar sipas të drejtës së një shteti të huaj.⁹ Njëherësh, një biznes kosovar quhet «shoqëri e huaj investuese» nëse:

[1] së paku dhjetë për qind (10%) të kapitalit të vetë është kontribuar direkt apo indirekt nga një investitor i huaj, ose

[2] kontrollohet nga një apo më shumë investitorë të huaj në bazë të një kontrate me shkrim, të drejtave për të ushtruar pjesën më të madhe të aksioneve votuese të organizatës apo të drejta ngjashme pronësore, ose të drejtat për të emëruar pjesën

5 LGj, nenet 13.1.2 dhe 16.1.1; shih dhe nenin 16.1.4 (mbrojtja e konkurrencës).

6 LGj, neni 13.1.2.

7 LGj, nenet 13.5 dhe 16.3.

8 LIH, neni 2.1.2.

9 LIH, neni 2.1.3.3.

më të madhe të bordit të vetë të drejtorëve apo të organeve tjera mbikëqyrëse.¹⁰

21. Nga legjislacioni parësor, pra, nuk është e qartë nëse ndonjëra nga palët duhet të jetë investitor i huaj ose shoqëri e huaj investuese që lëndën ta shqyrtojë divizioni në fjalë. Kurse rregulloret e gjykatës heshtin sa u përket investitorëve.¹¹ Meqë ligji përmend «kontestet lidhur me investitorët e huaj», jo thjesht «me investitorët», juridiksioni i divizionit mund të jetë tejet i gjerë.
22. Në rastin e Z Mobiles, pronësia është e ndarë: shtetasi kosovar Blerim Devolli ka 90 për qind të aksioneve, kurse kompania «K-com group l.l.c.» 10 për qind.¹²
23. K-com nuk figuron e regjistruar në Kosovë, andaj supozojmë se është shoqëri tregtare e themeluar jashtë vendit, çka e bën atë investitor të huaj. Paditësja nuk mund të vlerësojë nëse K-com ka kontribuar të dhjetën e kapitalit të Z Mobiles, që Z Mobile të jetë shoqëri e huaj investuese. Por duke u nisur nga pjesëmarrja në pronësi e personit të huaj, propozon që lëndën ta marrë sipër Divizioni për kontestet lidhur me investitorët e huaj.

B. Lejueshmëria e padisë

24. Gjykata duhet ta pranojë padinë meqë atë po e paraqet pala e autorizuar brenda afatit të lejuar dhe për kërkesa të lejuara.

Legjitimiteti i paditëses

25. Neni 95 i Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve thotë: «Për nulitetin gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe në atë mund të thirret çdo person i interesuar».
26. Komentari i LMD-së tutje shpjegon se:

Personat e interesuar për të kërkuar vërtetimin e nulitetit të kontratës absolutisht nule janë: çdo person që ka interes juridik, palët kontraktuese, pasardhësit e tyre universalë apo sin-

10 LIH, neni 2.1.8.

11 Shih Rregullore nr. 02/2020 për organizimin dhe veprimtarinë e brendshme të gjykatave të Republikës së Kosovës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, 8.7.2020.

12 Shtojca 4: Ekstrakt nga ARBK për DARDAFON.net L.L.C.

gularë, por këtë është e detyruar ta bëjë edhe gjykata sipas detyrës zyrtare si dhe çdo person i tretë që mund të ketë interes në vërtetimin se një kontratë e caktuar është nule. Gjithsesi, me të tretin kuptojmë edhe organet shtetërore, të cilat janë të autorizuar të mbrojnë interesat publike. Këtë nuk mund ta kërkojë pala e pandërgjegjshme.¹³

27. Organ i autorizuar për të mbrojtur interesat publike është Prokuroria e Shtetit. Por parë gjuhësisht, Komentari nuk jep listë shteruese të palëve të interesuara: thotë «kuptojmë edhe organet shtetërore».¹⁴ Ndonëse nuk është burim detyrues i së drejtës, Komentari me autor civilistin Adem Vokshi shpjegon mjaft bindshëm qëllimin e ligjvënësve sa i përket nulitetit të kontratës.
28. Ligji detyron gjykatën që vetë ta shqyrtojë vlefshmërinë e Marrëveshjes mes Telekomit e Z Mobiles. Por njëherësh autorizon paditësen që t'i drejtohet gjykatës për nulitetin e Marrëveshjes.
29. Ndonëse palë e tretë, Sindikata, zyrtarisht e njohur si Federata Sindikale e Pavarur e PTK-së, ka interes të drejtpërdrejtë në këtë çështje. Sindikata përfaqëson punëtorët e Telekomit të Kosovës, që me punën e tyre kanë zbatuar Marrëveshjen dhe që rrezikohen nga pasojat juridike dhe ekonomike të Marrëveshjes. Andaj, ka «interes në vërtetimin se [kjo] kontratë [...] është nule»,¹⁵ dhe llogaritet palë e interesuar që mund të parashtojë këtë padi sipas nenit 95.

Afati

30. Njëherësh, neni 96 i LMD-së thotë: «E drejta e paraqitjes së kërkesës të nulitetit nuk shuhet». Mosparashkrimi i kësaj të drejte arsyetohet me natyrën deklarative të vendimit gjyqësor: gjykata nuk e zhvleftëson Marrëveshjen, por vetëm konstaton se ajo ka qenë e pavlefshme që nga çasti kur është lidhur.¹⁶ Kështu, kjo padi është e afatshme.

13 Adem Vokshi në *Komentari: Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve*, libri I (UNDP: Prishtinë, 2013), neni 95, kmt. 1(b), f. 111 (theksim i shtuar).

14 Po aty.

15 Po aty.

16 Komentari, sipër në shënimin 13, neni 96, f. 111–112.

Kërkesa për dëmshpërblim

31. Bashkë me kërkesën për të konstatuar nulitetin mund të parashtrohet dhe kërkesa për të kthyer sendet që janë marrë përmes kontratës nule, sipas nenit 90.¹⁷ Prandaj, kjo kërkesë është e lejueshme.

C. Propozim rreth legjitimitetit të paditëses

32. Për të mënjeluar mëdyshjet, megjithatë, paditësja i propozon Gjykatës së nderuar që në vendimin e parë të saj të zgjidhë çështjen e legjitimitetit të palëve. Gjykata mund ta marrë këtë vendim bashkë me vendimin mbi kërkesën për masa të sigurimit, parashtruar në pjesën VII të kësaj parashtrëse.

¹⁷ Po aty; shih dhe nenin 95, kmt. 1(a), f. 111.

IV. FAKTET

A. Palët

Paditësja

33. Paditësja, Federata Sindikale e Pavarur e PTK-së, shkurt «Sindikata», është organizatë që përfaqëson interesat e punëtorëve të dy ndërmarrjeve publike: Posta e Kosovës, SH.A., dhe Telekom i Kosovës, SH.A. Si punëtorë, anëtarët e Sindikatës bartin barrën më të madhe të Marrëveshjes mes të paditurit dhe Telekomit.

I padituri

34. I padituri, DARDAFON.net L.L.C., ndërmarrje private, është kompani rishitëse e shërbimeve të telefonisë. DARDAFON.net L.L.C. është themeluar më 12 dhjetor 2008, dhe ka numër të biznesit 70540878.¹⁸ Njihet në treg me emrin e brendit «Z Mobile» (po ashtu Z-Mobile dhe Zmobile).
35. DARDAFON.net L.L.C. mban një autorizim të përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve, lëshuar nga rregullatori ARKEP më 2014.¹⁹ Më parë, ka pasur një licencë të bartur më 2008 nga kompania Dardafon L.L.C., përmes një ecurie të kontestuar publikisht.²⁰
36. Dardafon L.L.C. është shoqëri tregtare e regjistruar më 9 janar 2007. Bart numër biznesi 70401181.²¹ Në regjistrin publik të bizneseve, emrat e pronarëve të ndërmarrjeve DARDAFON.net L.L.C. dhe Dardafon L.L.C. janë të ndryshëm.²²
37. Për lehtësi, ndërmarrjes Dardafon L.L.C. do t'i referohemi si Dardafon ose «Dardafoni i parë», kurse ndërmarrjes DARDAFON.net L.L.C. si Z Mobile.
38. Dardafoni i parë nuk është palë e paditur.

18 **Shtojca 4:** Ekstrat nga ARBK për DARDAFON.net L.L.C.

19 **Shtojca 9:** Regjistri i Njoftimit në ARKEP.

20 **Shtojca 10:** Regjistri i ndërmarrjeve të licencuara në ARKEP, 2012. Vërehet e pandryshuar adresa e paraardhësit të Dardafon.net-it, Dardafon L.L.C. Shih dhe **Shtojca 41:** Raporti i organizatës Çohu, f. 35.

21 **Shtojca 5:** Ekstrakt nga ARBK për Dardafon L.L.C.

22 Krahaso Shtojca 4 dhe Shtojca 5.

Pala e interesuar

39. Telekom i Kosovës, SH.A.,²³ është ndërmarrje publike dhe kompania më e vjetër në fushën e telekomunikacionit në vend. Është trashëgimtar i ndërmarrjes Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, Sh.A. (PTK), e cila është ndarë në dysh më 2012. Telekom njihet kryesisht për shërbimet e telefonisë mobile nën brendin «Vala».
40. Paditësja vlerëson se Telekom mund të jetë palë e interesuar, e cila duhet të njoftohet për padinë.

B. Marrëveshja

41. Më 16 janar 2009, Telekom (atëherë PTK) dhe Z Mobile kanë lidhur Marrëveshjen e mbështetjes së operatorit të rrjetit mobil virtual, e cila është objekt shqyrtimi i kësaj padie.²⁴
42. Marrëveshja e njeh Z Mobilen si operator të rrjetit mobil virtual, si dhe i jep të drejtën të ofrojë shërbime të telefonisë mobile në emër të vet, por duke shfrytëzuar infrastrukturën e operatorit amë, Telekomit të Kosovës.
43. Telekom i ndan Z Mobiles pa kufizime numra të telefonit dhe qasje në infrastrukturën e komunikimeve, duke përfshirë rrjetin e internetit 3G/4G. Kurse Z Mobile krijon vetë pakot e shërbimeve dhe ua shet ato konsumatorëve.

C. 2007–2012: Negociatat dhe problemet e hershme***Ideja fillestare për operator virtual të Telekomit***

44. Që nga paslufta e deri në shpalljen e pavarësisë, Telekomin e Kosovës (atëherë PTK) e kanë administruar kryesisht zyrtarët ndërkombëtarë.
45. Në prag të shpalljes së pavarësisë, njëri nga administratorët ndërkombëtarë ka vërejtur se tregu i telefonisë mobile ishte i ndarë në vija etnike. Ndërsa shumica shqiptare dhe komunitete të tjera përdornin shërbimet nën brendin Vala, komuniteti serb shërbehej nga operatorët të Serbisë që vepronin paligjshëm në territorin e Kosovës. Administratori

23 **Shtojca 3:** Ekstrat nga ARBK për Telekomin e Kosovës, SH.A.

24 **Shtojca 1:** Marrëveshja.

kishte vlerësuar se do të ishte me interes për shtetin e ri të Kosovës të kontrollonte tregun e telefonisë.

46. Në të njëjtën kohë, drejtuesit ndërkombëtarë të Telekomit kishin vërejtur se brendi Vala nuk gëzonte gjithaq popullaritet në mesin e të rinjve.
47. Për të depërtuar te këto grupe të veçanta demografike, kishin propozuar modelin e rishitjes përmes një ndërmarrjeje tjetër. Kjo ndërmarrje do të luante rolin e rishitësit (anglisht: *reseller*) ose operatorit virtual të telefonisë mobile (anglisht: *mobile virtual network operator* ose MVNO). Rishitësi ose operatori virtual ofron shërbime duke përdorur infrastrukturën e operatorit amë.
48. Në praktikën e shëndoshë, marrëveshjet e rishitjes dhe rrjetet virtuale sjellin përfitime për të dyja palët: rishitësit dhe operatorët virtualë fitojnë të drejtën për të ofruar shërbime, kurse operatorët kryesorë zgjerojnë praninë në pjesë të tregut që nuk i kanë arritur më parë. Marrëveshja përcakton saktë segmentin e klientëve dhe llojin e sasinë e shërbimeve. Pra, operatori amë dhe operatori virtual përplotësojnë njëri-tjetrin.
49. Por marrëdhënia me Z Mobilen as nuk i ka shërbyer qëllimit të zgjerimit të tregut e as nuk i ka prurë fitim Telekomit të Kosovës.

Fillimi i negociatave dhe ndërrimi i palëve

50. Nga fundi i vitit 2007, Telekomit i Kosovës (asokohe PTK) ka nisur negociatat me kompaninë Dardafon L.L.C. (Dardafoni i parë) për një kontratë të rishitjes së shërbimeve të telefonisë.
51. Gjatë negociatave, është ndërruar disa herë udhëheqja e lartë e Telekomit. Ndërmarrjen e kanë drejtuar tre kryeshefa të ndryshëm, duke përfshirë ushtrues detyre pa mandat të plotë.
52. Më 27 gusht 2008, Telekomit dhe Dardafoni i parë kanë nënshkruar një Marrëveshjen Parimore (*Heads of Agreement*).²⁵
53. Gjatë vitit, Telekomit i është dorëzuar dhe Draftmarrëveshja, që nuk përmban ndryshime thelbësore nga Marrëveshja e nënshkruar. Draftmarrëveshja ka dy versione: shqip dhe anglisht.²⁶

²⁵ Po aty, Aneksi 7 (Annex 7).

²⁶ **Shtojca 30:** Draftmarrëveshja anglisht; **Shtojca 31:** Draftmarrëveshja shqip.

54. Nga fundi i 2008-ës, vendin e Dardafoni i parë në negociata dhe në Marrëveshje e ka zënë i padituri DARDAFON.net L.L.C. (Z Mobile). Kështu, ndërsa marrëveshja e parimeve është nënshkruar me Dardafonin e parë, Marrëveshja e 2009-ës është lidhur me Z Mobilen.
55. Menjëherë pasi është nënshkruar Marrëveshja me Z Mobilen, aksionarët e Dardafonit të parë i kanë shkruar Telekomit (atëherë PTK) për t'u ankuar rreth kontratës. Në shkresën e tyre, kanë rikujtuar se negociatat janë zhvilluar me Dardafonin, ku ata janë aksionarë, kurse Marrëveshja është lidhur me DARDAFON.net-in (Z Mobile), që është entitet tjetër.

Këshilla e ekspertëve kundër Marrëveshjes: Kanë paralajmëruar humbje të klientëve dhe të të hyrave. Telekomit i ka shpërfillur.

56. Bordi i Drejtorëve të Telekomit ka kërkuar fillimisht këshillën e një grupi punues. Grupi e ka konsideruar të leverdishme nëse Telekomit merr vetëm 22 për qind nga të ardhurat e biznesit me Z Mobilen.²⁷
57. Si për ta ndërlikuar gjendjen, grupi punues nuk ka dorëzuar me shkrim mendimin e vet. Vetëm njëri nga anëtarët ka përpiluar shkresë, në të cilën përshkruan punën e grupit, por thotë se po shpreh pikëpamjet e veta.
58. Auditori i brendshëm e ka cilësuar të mangët këshillën e grupit punues, dhe e ka detyruar Bordin e Drejtorëve të angazhojë një tjetër grup të ekspertëve për të analizuar Draftmarrëveshjen.
59. Grupi i dytë, i përbërë prej zyrtarësh të lartë dhe ekspertësh të dëshmuar të Telekomit, e ka këshilluar Bordin kundër bashkëpunimit të propozuar.²⁸ Pas një analize të hollësishme, të mbështetur në referenca shkencore dhe krahasime me prirjet globale, grupi i dytë ka vlerësuar se Draftmarrëveshja është e pafavorshme për PTK-në në thuajse çdo aspekt thelbësor.
60. Në raportin e vet, grupi i dytë shpjegonte se operatorët virtualë angazhohen për t'u shitur shërbime segmenteve të caktuara të tregut, tek të cilat operatori amë nuk arrin të depërtojë. «Nuk paraqet zgjuarsi për

27 **Shtojca 33:** Procesverbali i mbledhjes nr. 15 të Bordit [...], 20.10.2008, pika 2.25.

28 **Shtojca 32:** Dokumenti i Bordit të Drejtorëve të PTK-së, 20.10.2008.

një operator shitja e kapaciteteve një operatori tjetër nëse operatori tjetër ka për cak synim) tregun e njëjtë», thotë raporti i grupit, duke cituar një nga ekspertët botërorë të telekomunikacionit. Tutje, cek se strategjia më e qëlluar është që operatorit virtual me i dhënë shërbime që operator kryesor «nuk i konsideron shërbime të dorës së parë».²⁹

61. Veçmas, grupi i dytë e quante të papranueshme ndarjen e të hyrave 78 për qind operatorit virtual e 22 për qind Telekomit.
62. Tutje, duke analizuar mënyrën e barazimit, grupi i dytë paralajmëroi humbje në arkëtimin e të hyrave. Për dallim nga aranzhimet e rrjeteve virtuale në vendet e tjera, Marrëveshja nuk llogarit të hyrat sipas shitjeve me shumicë nga operator kryesor por sipas të hyrave që deklarohet vetë operator virtual. Për këtë arsye, ekspertët e grupit të dytë vlerësuan se Telekom *nuk do të mund të matë saktë të hyrat, dhe se operatori virtual mund ta mashtrojë Telekomin*. Për më tepër, e panë të parrsyeshme me i llogaritë vetëm të ardhurat e arkëtuara dhe që barazimi të ndodhë një herë në katër muaj.³⁰ Prandaj, *këshilluan Bordin e ndërmarrjes që të mos lidhte Marrëveshjen*.
63. Stafi i Telekomit ka dhënë disa komente kryesisht sipërfaqësore në Draftmarrëveshjen shqip, kurse juristët ndërkombëtarë që kanë përkrahur Telekomin kanë dhënë komente më të hollësishme në Draftmarrëveshjen anglisht.³¹
64. Por Bordi ka shpërfillur këshillën e grupit të dytë, dhe ka vendosur ta pranojë Draftmarrëveshjen shqip, sipas këshillës së çalët të grupit të parë.³² Bordi gjithashtu ka anashkaluar komentet e juristëve ndërkombëtarë në versionin anglisht të Draftmarrëveshjes.

Mashtrimet sim-to-sim të Z Mobiles

65. Që në vitet e para të operimit, Z Mobile është përfshirë në veprimtari të paligjshme, që i shkaktojnë humbje të rënda operatorëve të telekomunikimit në botë.

29 Po aty, f. 4 (theksim i shtuar).

30 Po aty; shih dhe Shtojca 41: Raporti i organizatës Çohu, f. 35.

31 Shtojca 30: Draftmarrëveshja anglisht; Shtojca 31: Draftmarrëveshja shqip.

32 Shtojca 33: Procesverbali, pika 2.25.

66. Qysh prej se ka nisur shërbimet e telefonisë mobile, Telekom i Kosovës ka përdorur kodin shtetëror të Monakos (+377) dhe ka realizuar trafikun ndërkombëtar në bashkëpunim me ndërmarrjen monegaske, Monaco Telecom. (Madje, Telekom i Kosovës ende nuk ka kaluar plotësisht në kodin vendor +383.)
67. Trafiku ndërkombëtar është një nga burimet madhore të të hyrave për operatorët telefonikë. Sipas praktikës, operatori i huaj që nis thirrjen ndërkombëtare drejt një numri të Telekomit të Kosovës paguan tarifën prej 28 eurocentë për çdo thirrje të pranuar. Prej tyre, 16 eurocentë i mban Telekom i Kosovës dhe 12 Monaco Telecomi.
68. Më 2010, Monaco Telecom i është ankuar Telekomit për shkallën e lartë të ridrejtimin të trafikut *sim-to-sim* në numrat e Z Mobiles.³³ Në këso rastesh, thirrjet ridrejtohen përmes internetit në kartela SIM vendore, ashtu që Monaco Telecomi dhe Telekom i Kosovës nuk arrijnë të regjistrojnë pranimin e thirrjes dhe të arkëtojnë tarifën prej 28 eurocentësh.
69. Keqpërdorimet e tilla kanë vazhduar që atëherë, dhe janë identifikuar së mbrami në raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për 2018-ën.³⁴ Rreth 90 për qind e veprimeve *sim-to-sim* janë kryer me numrat e Z Mobiles.³⁵
70. Telekom i Kosovës nuk ka marrë masa të duhura ndaj Z Mobiles lidhur me mashtrimet *sim-to-sim*. Neni 8.3 i Marrëveshjes lejon edhe shkëputjen në rast mashtrimesh.³⁶

Mospajtimet e para rreth kostos së numrave dhe kartelave SIM

71. Qysh herët, Telekom i Kosovës ka hasur në mospajtime rreth dispozitave të Marrëveshjes.
72. Së pari, Z Mobile nuk ka pranuar t'i paguajë Telekomit kostot e mirëmbajtjes së numrave. Meqë Telekom i Kosovës ka përdorur kodin shtetëror të Monakos (+377), është detyruar t'i paguajë Monaco Telecomit 50 eurocentë për çdo numër, duke përfshirë numrat e Z Mobiles. (Te-

33 **Shtojca 34:** Shkresë nga Monaco Telecom, 2010.

34 **Shtojca 7:** Auditimi 2018, f. 39.

35 Po aty.

36 Shtojca 1: Marrëveshja.

lekomi i Kosovës ende nuk është shkëputur plotësisht nga kodi mone-gask.) Z Mobile nuk ka kontribuar kurrë astenjë qindarkë, me arsyeti-min se Marrëveshja nuk parasheh pagesa për numra.

73. Në ndërkohë janë shfaqur mosmarrëveshje edhe rreth kartelave SIM. Më 21 prill 2011, Z Mobile i ka paraqitur Telekomit fatura për kom-pensim lidhur me kartelat. Vlera e faturave kalonte milionat.

Ekspertët e Z Mobiles: Z-ja s'është operator, por rishitës i thjeshtë. Margjina e fitimit, shqetësim madhor. Garanca bankare, e ulët.

74. Andaj, më 2012, Z Mobile ka angazhuar një kompani konsulence, Analysis Maison, për të analizuar mangësitë e Marrëveshjes.
75. Analysis Maison ka dhënë një mendim eksperti, duke u mbështetë në analiza krahasuese (*benchmark analysis*).³⁷ Veçmas, ka krahasuar Ma-rrëveshjen Telekomit–Z Mobile me kontratat që kompani të ndryshme botërore kanë lidhur me rishitës dhe operatorë virtualë.
76. Vlen të ceket se kompania konsulente ka dhënë mendimin duke u mbështetur në dokumentet e dorëzuara nga Z Mobile.³⁸ Kështu, mendimi mund të pandehet se paraqet Z Mobilen në dritë më të favorshme.
77. Analysis Maison radhit katër kategori të rishitësve dhe operatorëve virtualë, sipas infrastrukturës që zotërojnë, nivelit të shërbimit dhe margjinës së shitjes me pakicë:
- (1) ofrues shërbimesh ose rishitës:
 - (a) nuk ka infrastrukturë të veten
 - (b) margjinë 3–12 për qind
 - (2) operator virtual i lehtë (*light MVNO*):
 - (a) disa platforma të veta
 - (b) por përdor kryesisht infrastrukturën e operatorit amë
 - (c) margjinë 41–60 për qind
 - (3) operator i romingut kombëtar:

37 **Shtojca 35:** Mendimi i ekspertit nga Analysis Maison, 2012.

38 Po aty, f. 4.

- (a) të gjitha platformat kryesore
 - (b) disa pajisje të rrjetit
 - (c) margjinë 32–58 për qind
 - (d) por shet më pak se një operator virtual i plotë
- (4) operator virtual i plotë (*full MVNO*):
- (a) të gjitha platformat kryesore
 - (b) disa pajisje të rrjetit
 - (c) margjinë 73–77 për qind
 - (d) shet më së shumti³⁹

78. Duke vlerësuar natyrën e shërbimeve, Analysis Maison e cilëson Z Mobilen si ofrues shërbimesh ose rishitës. Por thekson se margjinën e shitjes me pakicë e ka shumëfish më të lartë.⁴⁰

79. Në bazë të të dhënave krahasuese, Analysis Maison ka cilësuar shqetësim madhor (*major concern*) çmimin e blerjes, duke konkluduar se:

margjina e shitjes me pakicë [...] është jashtëzakonisht e ulët për një marrëveshje të ofruesit të shërbimeve. Për më tepër, nuk zbatohen kurrfarë pagesash shtesë për të kompensuar për normën e ulët të shitjes me shumicë.⁴¹

80. Tutje, duke marrë parasysh se kontratat me operatorët virtualë rëndom përfshijnë garancë bankare, Analysis Maison gjithashtu ka gjetur se vlera e garancës që Z Mobile i ka dhënë Telekomit «është shumë e ulët».⁴²

81. Për krahasim, garanca mbulon shumën prej 30 mijë eurosh.⁴³ Kurse Z Mobile ka pasur mbi 10 milionë euro të hyra vetëm gjatë vitit 2018.⁴⁴ Sipas llogaritjeve të bëra në qershor 2019, Z Mobile ka fituar mbi 73 milionë euro nga Marrëveshja, shumicën e të cilave tashmë i ka arkë-

39 Po aty, f. 9.

40 Po aty.

41 Po aty, f. 5.

42 Po aty, f. 6.

43 Po aty, f. 13.

44 Llogaritur sipas Shtojca 8: ARKEP, Pasqyrë e tregut, f. 2.

tuar.⁴⁵ Telekom i ka shënuar mbi 107 milionë euro humbje reale dhe mbi 140 milionë fitim të humbur.⁴⁶ Shifrat sot janë ende më të larta.

D. 2013–2016: Procedurat vendore dhe arbitrazhi ndërkombëtar

Rasti administrativ në gjykatë: Z Mobile është ankuar te rregullatori, kurse Telekom i ka paditur rregullatorin

82. Më 2013, Z Mobile ka nisur një procedurë administrative lidhur me numrat. Duke pretenduar se ka në shfrytëzim 95 për qind të serive 045-5xx-xxx dhe 045-6xx-xxx, Z i ka kërkuar organit rregullator, ARKEP, 100 mijë numra të rinj. ARKEP-i ka rehatuar kërkesën më 18 korrik 2013, kur me Vendimin nr. 381 ka urdhëruar Telekomin e Kosovës që t'ia kalojë Z Mobiles thujse të gjithë numrat nga seria 045-7xx-xxx.⁴⁷ Më 16 gusht 2013, Telekom i ka ngritur padi për konflikt administrativ, duke i kërkuar Gjykatës Themelore të Prishtinës ta anulojë vendimin e ARKEP-it.⁴⁸ Procedura nuk ka mbaruar.

Përpjekja për përmbarim: Kërkesat e Z Mobiles qenë parashkruar

83. Më 7 nëntor 2014, Z Mobile i ka kërkuar një përmbaruesi privat ta ekzekutojë një borxh kundër Telekomit në lidhje me kartelat SIM. Por në prapësimin e vet, Telekom i është thirrur me sukses në parashkrimin e kërkesës, meqë kishin kaluar tri vjet nga lëshimi i faturës.⁴⁹

Arbitrazhi: Pa përfunduar procedurat në Kosovë, Z Mobile ka nisur arbitrazhin në Londër

84. Paskëtaj, Z Mobile i është drejtuar tribunalit të arbitrazhit. Në padinë e 29 janar 2016, Z Mobile ka ngritur pretendimet për numrat e rinj, kartelat dhe rrjetin 3G e 4G.⁵⁰
85. Telekom i Kosovës e ka kundërshtuar që në fillim kompetencën e tribunalit, duke u thirrur dhe në parashkrimin e një pjese të kërkesëpa-

45 **Shtojca 40:** Prezantimi i dëmeve, f. 10, 12.

46 Po aty, f. 2, 13.

47 **Shtojca 6:** Vendim nr. 381, ARKEP, 18.7.2013.

48 **Shtojca 11:** Rasti A. nr. 1092/13, GjThP-DA, Padia, 16.8.2013.

49 Rasti PPP nr. 343/14, GjThP.

50 **Shtojca 13:** Rasti 20990/MHM, tribunali ICC, Padia, 29.1.2016.

disë.⁵¹ Por tribunali nuk e ka pranuar kundërshtimin, dhe ka shpallur veten kompetent për të gjykuar lëndën me vendimin e pjesshëm të 21 nëntorit 2016.⁵² Rrjedhimisht, Telekomit është detyruar ta mbrojë veten në procedurën e arbitrazhit, të cilën e ka ndjekur me vështirësi të shumta.

86. Më 9 dhjetor 2016, tribunali ka nxjerrë vendimin e tij përfundimtar, në favor të Z Mobiles.⁵³ Detyrimet e Telekomit janë të shumëfishta dhe të shumëllojshme.

87. Ndër të tjera, vendimi detyron Telekomin që, në bazë të Marrëveshjes së 2009-ës:

- (1) t'i përmbushë detyrimet ndaj Z Mobiles — pa kufizim në sasi dhe në kohë:
 - (a) ndarjen e numrave;
 - (b) ndarjen e kartelave sim; dhe
 - (c) ofrimin e qasjes në rrjetet 3G dhe 4G, ndonëse këto nuk përmenden shprehimisht në Marrëveshje;
- (2) t'i paguajë Z Mobiles si dëmshpërblime:
 - (a) kompensimin prej 8.785.000 eurosh të dëmeve të likuiduara për vonesa plus kamatën prej 8 për qind;
 - (b) kompensimin prej 17.315.000 eurosh të fitimit të humbur plus kamatën prej 8 për qind;
 - (c) nga 5.000 euro të dëmeve të likuiduara (dënim ditor) për çdo ditë vonese në përmbushjen e secilit detyrim, gjithsej deri në 17.315.000 euro; dhe
 - (d) shpenzimet e procedurës së arbitrazhit në lartësi prej 972.121,22 eurosh dhe 534.000,00 dollarësh amerikanë.⁵⁴

51 **Shtojca 14:** Po ai rast, Përgjigjja në padi, 29.4.2016, para. 96 e tutje.

52 **Shtojca 15:** Po ai rast, Vendimi i pjesshëm i arbitrazhit, 21.9.2016.

53 **Shtojca 16:** Po ai rast, Vendimi përfundimtar i arbitrazhit, 9.12.2016.

54 Po aty, dispozitivi, VI.

Mospagimi i çmimit

88. Diku rreth vitit 2016, Z Mobile ka pushuar së paguari Telekomit 27 për qind të të ardhurave që i takojnë me Marrëveshjen e 2009-ës. Mospagimi vijon edhe sot.⁵⁵

E. 2017–2020: Veprimet pas arbitrazhit dhe problemet e reja***Në gjykatë vendore: Telekomit ka kërkuar anulimin e vendimit; Gjykata ka ndërprerë procedurën e njohjes***

89. Më 19 janar 2017, Telekomit i Kosovës ka ngritur padi për anulimin e vendimit të arbitrazhit.⁵⁶ Pak ditë më vonë, prokurori i shtetit ka parashtruar Gjykatës Supreme kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër vendimit të arbitrazhit.⁵⁷
90. Disa muaj më vonë, më 5 prill 2017, Z Mobile i ka paraqitur kësaj Gjykate kërkesën për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit.⁵⁸
91. Telekomit ka parashtruar kundërshtimin e vet ndaj kërkesës për njohje dhe ekzekutim. Telekomit ka kërkuar ndërprerjen e procedurës për shkak të dy procedurave paraprake, padisë për anulim dhe mbrojtjes së ligjshmërisë.⁵⁹ Gjithashtu, ka lutur Gjykatën ta refuzojë kërkesën e Z Mobiles për një varg arsyesh. Së pari, klauzola e arbitrazhit nuk e shpreh vullnetin e palëve për vendin e arbitrimit.⁶⁰ Së dyti, tribunali nuk ka qenë kompetent ta trajtojë lëndën: vendimi prek çështje administrative dhe pronën e paluajtshme, për të cilat vendos përjashtimisht Gjykata.⁶¹ Dhe së fundi, njohja e ekzekutimi i vendimit do të ndryshnin rendin publik në vend.⁶²
92. Në seancën e mbajtur më 19 maj 2017, gjyqtari i nderuar Murat Paçarada ka pranuar propozimin e Telekomit për ndërprerjen e procedurës deri në zgjidhjen e rasteve paraprake — padisë për anulim dhe mbrojt-

55 **Shtojca 7:** Auditimi 2018, f. 8.

56 **Shtojca 17:** Rasti II.EK. nr. 20/17, GjThP-DE, Padia, 19.1.2017.

57 **Shtojca 19:** Rasti KMLA nr. 1/17, Kërkesa, 26.1.2017.

58 **Shtojca 20:** Rasti IV.V.C. nr. 118/17, GjThP-DE, Propozimi, 7.3.2017.

59 **Shtojca 21:** Po ai rast, Kundërshtimi, 11.4.2017, pika II.

60 Po aty, pikat III.A dhe V.

61 Po aty, pika III.B dhe V.

62 Po aty, pika V.

jes së ligjshmërisë.⁶³ Meqë procedura është ndërprerë, gjykata nuk ka vendosur rreth meritave të kërkesës së Z Mobiles për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit.⁶⁴

Ujdia jashtëgjyqësore: Palët janë pajtuar rreth përmbarimit të borxhit, dhe Telekomit ka tërhequr padinë

93. Por palët nuk kanë pritur mbarimin e procedurave gjyqësore për ta zgjidhur kontestin. Më 24 maj 2017, ato kanë lidhur një marrëveshje të dytë për përmbarimin e vendimit të arbitrazhit. Telekomit është pajtuar të paguajë një pjesë të borxhit nga vendimi i arbitrazhit dhe të tërheqë paditë lidhur me Z Mobilen, kurse Z Mobile ka tërhequr propozimin për njohje.⁶⁵ Për ta larë borxhin, Telekomit ka hequr dorë nga arkëtimi i 27-përqindëshin të të hyrave nga shitja e shërbimeve, që i takon me Marrëveshje.⁶⁶ Gjithashtu, Ujdia jashtëgjyqësore ka shtyrë afatin e Marrëveshjes për 4 vjet e gjysmë, duke e zhvendosur datën e skadimit nga 30 korriku 2019 në 31 dhjetor 2023.⁶⁷

94. Mirëpo kur është lidhur Ujdia, Bordi i Drejtorëve të Telekomit ka qenë i shpërbërë dhe nuk ka mundur ta miratojë atë. Duke qenë se kryeshefi nuk ka pasur autorizimin e nevojshëm, palët kanë paraparë mundësinë e ratifikimit pas emërimit dhe funksionalizimit të Bordit të ri:

Telekomit, duke e marr parasysh statusin e të qenurit kompani publike dhe realitetin se në momentin e nënshkrimit të kësaj marrëveshje [dmth. Ujdisë] për zbatimin e Vendimit të Arbitrazhit, operon pa Bord të Drejtorëve (“BiD”), kjo Marrëveshje pas emërimit të BiD nga Aksionari brenda periudhës 6 mujore kalendarike pas emërimit të BtD nga Aksionari dhe funksionalizimit të punës së tij, Telekomit në mënyrë të njëanshme mund të vendosë që të tërhiqet nga kjo Marrëveshje. Me këtë rast, do të konsiderohet se kjo Marrëveshje nuk ka ekzistuar dhe Telekomit pranon kthimin në situatën nga vendimi final i arbitrazhit 20990/MHM datës 09.12.2016, ndërsa obligimet eventuale të kryera/paguara nga Telekomit deri në atë kohë si respektim i kësaj marrëveshje, do të kalkuloohen në mënyrën dhe kuptimin

63 **Shtojca 22:** Rasti IV.V.C. nr. 118/17, GjThP-DE, Procesverbal, 19.5.2017, f. 4.

64 Po aty.

65 **Shtojca 2:** Ujdia jashtëgjyqësore, neni 8.1.

66 Po aty, neni 5.1.

67 Po aty, neni 4.2.

e ekzekutimit të dispozitave bazë të vendimit final të arbitrazhit [...]. Pas kalimit të afatit 6 mujor, Telekomit nuk mund të zbatohet të drejtën e tyre për tërheqjen nga kjo Marrëveshje. [sic]⁶⁸

95. Palët kanë filluar menjëherë ta zbatojnë Ujdinë. Telekomit ka tërhequr padinë për anulimin e vendimit të arbitrazhit dhe padinë ndaj ARKEP-it, dhe Z Mobile e ka tërhequr kërkesën për njohje dhe ekzekutim.

Zgjidhja e Ujdisë: Z Mobile e ka shkëputur njëanshëm, pa bazë, duke vënë Telekomin në lajthitje

96. Ndërkaq, aksionari i Telekomit ka emëruar anëtarët e ri të Bordit më 29 mars 2018. Bordi është funksionalizuar shpejt, më 11 prill 2018, kur ka mbajtur mbledhjen e parë.
97. Veçse mirëbesimi i ka munguar Z Mobiles, që ka ndërruar mendje rreth Ujdisë. Më 27 prill 2018, drejtori ligjor i Z Mobiles i ka shkruar letër kryeshefit të Telekomit, duke ngritur pretendime të pabaza dhe duke njoftuar shkëputjen e njëanshme të Ujdisë.⁶⁹
98. Se pretendimet kanë qenë të pabaza e shpjegon letra e kryeshefit të Telekomit, që e kundërshton shkëputjen.⁷⁰
99. Rrjedha e marrëdhënieve mes palëve gjatë verës ka bindur Telekomin se Ujdia është në fuqi.

Kërkesa e përtërirë dhe njohja e vendimit të arbitrazhit

100. Por tinëzisht Z-ja i është drejtuar Gjykatës. Më 16 korrik 2018, ka paraqitur kërkesën për njohje dhe ekzekutim të vendimit të huaj të arbitrazhit. Kjo kërkesë i ka arritur Telekomit me aktin përcjellës të Gjykatës më 2 tetor 2018⁷¹ — pra, një javë para se t'i kalojë afati Bordit për ta ratifikuar ose hedhur poshtë Ujdinë.
101. Telekomit e ka kundërshtuar propozimin, duke paraqitur pak a shumë të njëjtat argumente si në kundërshtimin e vitit 2017.⁷² Z Mobile ka

68 Po aty, neni 8.2.

69 **Shtojca 36:** Z Mobile, «Njoftim për shkëputjen e kontratës», 27.4.2018.

70 **Shtojca 37:** Telekomit, «Përgjigje në Njoftimin [...]», 29.6.2018.

71 **Shtojca 23:** Rasti IV.C. nr. 338/18, GjThP-DE, Propozimi, 16.7.2018.

72 **Shtojca 24:** Po ai rast, Kundërshtim, 8.10.2018.

parashtruar përgjigje ndaj kundërshtimi,⁷³ ndërsa Telekomu ka replikuar me kundërgjyqësore dhe me kërkesë për seancë gjyqësore.⁷⁴

102. Më 11 shkurt 2019, Gjykata Themelore e Prishtinës e ka njohur vendimin e arbitrazhit.⁷⁵

Negociatat për ripërtëritjen e Marrëveshjes

103. Marrëveshja parasheh negociata për vazhdimin e saj. Neni 3.1 thotë:

Kohëzgjata e kësaj marrëveshje do të jetë e njëjtë me kohëzgjatjen e mbetur të Licencës së PTK-së për instalim, mirëmbajtje dhe operim të Rrjetit publik të komunikimit mobil GSM në territorin e Kosovës dhënë nga ART (referenca ART-114/04 të datës 30 Korrik 2004), “Kohëzgjatja e Licencës”.

Palet dakordohen se se paku 6 muaj para skadimit të kësaj marrëveshje (e cila është në përputhje me kohëzgjatjen e licencës së PTK-së) do të takohen dhe do të diskutojnë në mirëbesim zgjatjen e kësaj marrëveshje sipas kushteve të reja të Licencës.⁷⁶

104. Pra, palët duhet të fillojnë negociatat e ripërtëritjes gjashtë muaj para skadimit të Marrëveshjes.⁷⁷ Nga neni 3.1, rrjedh se Marrëveshja skadon kur mbaron licenca e ish-PTK-së. Licenca është lëshuar në korrik 2004 për 15 vjet. Kështu Marrëveshja është paraparë të skadojë në korrik 2019, që i bie se gjashtëmuajshi para skadimit ka nisur në janar.
105. Z Mobile ka pranuar 30 korrikun 2019 si datë skadimi të Marrëveshjes në Ujdi të jashtëgjyqësore të nënshkruar në maj 2017.⁷⁸ Dy ndërmarrjet kanë nisur negociatat në janar, çka nënkupton se Marrëveshja do të skadonte pas 6 muajsh.
106. Telekomu e Z Mobile kanë zhvilluar negociata për ta vazhduar Marrëveshjen, por s’kanë arritur pajtim brenda afatit të paraparë. Nga janari në qershor, Telekomu e Z Mobile kanë mbajtur të paktën gjashtë takime: më 22 janar, 22 shkurt, 21 mars, 19 prill, 5 maj dhe 6 qershor.⁷⁹

73 **Shtojca 25:** Po ai rast, Përgjigje në kundërshtim, 29.10.2018.

74 **Shtojca 26:** Po ai rast, Kërkesë për seancë, 6.11.2019.

75 **Shtojca 27:** Po ai rast, Aktvendim, 11.2.2019; shih sipër para. 87 të kësaj padie.

76 Marrëveshja, neni 3.1.

77 Marrëveshja, neni 3.1, para. 2.

78 Ujdia jashtëgjyqësore, neni 4.2.

107. Më 24 qershor, Telekom i ka shkruar Z Mobiles, duke përsëritur vullnetin për të negociuar kontratë të re, që do të vazhdonte bashkëpunimin edhe pas 30 korrikut 2019.⁸⁰
108. Në ndërkohë, më 15 korrik, Z Mobile ka nisur procedurën për të përmbuar vendimin e arbitrazhit përmes përmbaruesit privat, duke i kërkuar Telekomit 25 milionë euro.⁸¹ Telekom i ka paraqitur prapësim.
109. Më 18 korrik 2019, Telekom i ka bërë një ofertë Z Mobiles për kontratë të re, por Z Mobile nuk e ka pranuar.
110. Më 30 korrik 2019, kryeshefi i Telekomit e ka njoftuar Z Mobilen se Marrëveshja do të skadojë në fund të ditës, ashtu siç parashihet me nenin 3.
111. Në njoftimin me shkrim për skadimin e Marrëveshjes, kryeshefi ka lajmëruar se Telekom i do t'u shërbente klientëve të Z Mobiles gjatë një periudhe kalimtare, deri në 120 ditë.
112. Klientët e Z Mobiles kanë kaluar plotësisht në sistemin e Telekomit brenda nëntorit 2019.

Arbitrazhi i ri dhe përmbarimi i të vjetrit

113. Më 22 tetor 2019, ende pa përfunduar periudha kalimtare, Z Mobile ka nisur procedurë të re të arbitrazhit kundër Telekomit, para ICC-së në Paris. Z Mobile pretendon:
- (1) Telekom i ka shkëputur pa të drejtë shërbimet, sepse Marrëveshja nuk ka skaduar;
 - (2) Marrëveshja nuk ka skaduar, sepse rregullatori i ka vazhduar licencën Telekomit dhe Marrëveshja skadon bashkë me licencën; dhe
 - (3) Telekom i ka dështuar të negociojë vazhdimin e Marrëveshjes në mirëbesim.⁸²

79 **Shtojca 38:** Telekom i, «Njoftim», Z Mobiles, 24.6.2019; **Shtojca 43:** Albiona Ahmeti, «Me 30 korrik Telekom i [...]?»», *Gazeta Express*, 26.6.2019.

80 Shtojca 38: Telekom i, ..., 24.6.2019; Shtojca 43: Ahmeti, ..., 26.6.2019.

81 **Shtojca 44:** Valon Fana, «Devollët dërgojnë [...]»», *Kallxo.com*, 15.7.2019.

82 **Shtojca 28:** *Draft Terms of Reference*, para. 23, 69.

114. Z Mobile po kërkon dëmshpërblim dhe vazhdim kontrate, në vlerë prej dhjetëra milionash.
115. Më 6 korrik 2020, gjykata vendore ka njohur të drejtën e Z Mobiles për të përmbuar vendimin e arbitrazhit të 2016-ës, përmes përmbauesit privat. Gjykata ka refuzuar thujtë krejt prapësimin e Telekomit. Shuma e lejuar për përmbuarim është 24.684.003,15 euro nga 25 milionë sa janë kërkuar fillimisht.⁸³

F. Epilogu i Marrëveshjes

Zgjerimi i Z Mobiles në treg

116. Që nga themelimi, Z Mobile ka vijuar të zgjerojë praninë në treg, duke shitur shërbimet më lirë se ç'kushton për t'i mundësuar ato. Këtë ka mundur ta bëjë në sajë të bashkëpunimit me Telekomin. Si operator virtual, Z Mobile ka kryer vetëm një pjesë të shërbimeve; punën më të madhe e ka bërë Telekomit me stafin dhe infrastrukturën e vet.⁸⁴ Rrjedhimisht, Z Mobile ka pasur leverdi të shesë nën çmim, dhe ka arritur të fitojë klientë pa investuar në mirëmbajtjen ose zhvillimin e teknologjisë.
117. Telekomit nuk ka ndërmarrë veprime të duhura për ta penguar Z Mobilen. Me marrëveshjen e 2009-ës, Z Mobile detyrohet ta njoftojë Telekomin për parashikimet e trafikut (pra, se sa do ta ngarkojnë klientët e Z-së rrjetin e Telekomit). Por palët asnjëherë nuk e kanë zbatuar këtë dispozitë.⁸⁵
118. Sipas të dhënave të ARKEP-it për 2019-ën, Z Mobile ka përvetësuar të paktën 20 për qind të të gjithë klientëve që përdorin rrjetin e Telekomit. Bashkërisht, Z Mobile dhe Vala e Telekomit zotëronin rreth dy të tretat e tregut të telefonisë mobile.⁸⁶
119. Por klientët e Z Mobiles shfrytëzonin mbi 40 për qind të rrjetit të Telekomit për biseda me zë dhe përftonin mbi 40 për qind të trafikut

83 **Shtojca 29:** Rasti PPP. nr. 1486/2019, GjThP-DP, Aktvendim, 7.7.2020.

84 Shih Shtojca 35: Mendimi i ekspertit nga Analysis Maison, 2012, f. 9.

85 Shih Marrëveshjen, neni 6.2.2, para. 2.

86 **Shtojca 8:** ARKEP, Pasqyrë e tregut, f. 6.

3G.⁸⁷ Pra, trafiku nga Z Mobile ka qenë në shpërpjesëtim të theksuar me numrin e klientëve.

120. Përveç kësaj, Z Mobile ka zgjedhur gjithmonë teknologjinë më të avancuar për klientët e vet. Vetëm 7 për qind të myshterinjve të Valës kanë pasur qasje në teknologjinë 4G, kurse 33 për qind kanë përdorur 3G-në, që është një shkallë më poshtë për nga cilësia; shumica e Valës është shërbyer me teknologjinë thujse të papërdorshme 2G.⁸⁸ Në anën tjetër, rreth 60 për qind e klientëve të Z-së kanë qenë në 3G e 4G.⁸⁹
121. Z Mobile ka zgjeruar praninë në treg veçmas duke shfrytëzuar kërkesat në rritje për qasje në internet përmes rrjetit 3G/4G. Në fund të vitit 2018, Z Mobile u ka ofruar konsumatorëve të vet paketa mujore të shërbimeve të pakufizuara — thirrje me zë, mesazhe dhe internet — për çmime të shpërfillshme. Pakoja «PA LIMIT» është shitur për vetëm 2,99 euro.⁹⁰
122. Z Mobile nuk ka mbuluar koston e shërbimit për thirrjet dalëse drejt operatorit vendor Ipko dhe operatorëve ndërkombëtarë. Kjo rrethanë nuk do të ndryshonte edhe nëse Z Mobile do t’ia paguante Telekomit hisen që i takon me Marrëveshjen e 2009-ës.⁹¹
123. Përveçse kërkojnë të shfrytëzojnë sërish infrastrukturën e Telekomit si operator virtual, pronarët e Z Mobiles tani kanë mësyre të blejnë operatorin tjetër të telekomunikacionit, Ipko. Ata tashmë kontrollojnë një operator të komunikimeve elektronike, që ofron shërbime të internetit dhe kabllorit. Ky zgjerim i përmasave të monopolit do të kishte qenë i vështirë, në mos i pamundshëm, pa përfitimet e Z-së në kurriz të Valës dhe punëtorëve të saj.

Dëmtimi i infrastrukturës dhe tregut të telekomunikimeve

124. Çmimet e ulëta kanë joshur konsumatorët kosovarë, që dita-ditës përballen me varfëri në rritje. Por e ka kthyer telefoninë mobile të Kosovës në biznes të paqëndrueshëm.

87 **Shtojca 39:** Raporti i dëmeve, f. 20–21; **Shtojca 40:** Prezantimi i dëmeve, f. 25.

88 Prezantimi i dëmeve, f. 29.

89 Po aty, f. 30.

90 **Shtojca 42:** Pamje ekrani e videoreklamës.

91 Shih sipër para. 88 të kësaj padie.

125. Në radhë të parë, kanë pësuar klientët e Valës, meqë Z Mobile e ka ngarkuar tej mase rrjetin e Telekomit.⁹² Së dyti, operatorët e tjerë (duke përfshirë operatorët virtualë) kanë ngurruar të investojnë dhe ta zhvillojnë fushën e telekomunikimeve, meqë s'u kanë bërë dot ballë çmimeve të padenja të Z Mobiles. Së treti, as Telekomit nuk po arrin ta rimëkëmbë infrastrukturën e vet, meqë nuk ka siguruar të hyra të mjaftueshme.⁹³
126. Telekomit i mungojnë rreth 6,5 milionë euro për të siguruar përkrahjen e domosdoshme për pajisje kyçe të rrjetit. Me përkrahje të tillë, Telekomit do të arrinte të shkëputej plotësisht nga kodi shtetëror i Monakos dhe të shpëtonte të hyra të majme, që tani i paguhen shtetit të vogël evropian.
127. Gjendjen brenda Telekomit e ka identifikuar në hollësi Zyra Kombëtare e Auditimit. Raporti për vitin 2018 thotë se rrezikohet:
- Ndërprerje e plotë e të gjitha shërbimeve që afekton të gjithë konsumatorët në rrjet (Vala, Operatori mobil virtual, Romer);
 - Ndërprerje e pjesshme e shërbimit në zona të caktuara të mbulimit;
 - Kohëzgjatje e madhe e zgjidhjes së problemit/defektit;
 - Pamundësi e neutralizimit të problemit; dhe
 - Pamundësi e riparimit të pajisjeve me defekt.⁹⁴
128. Në një raport të hartuar në qershor 2019, inxhinierët e Telekomit kanë vlerësuar humbjet reale të Telekomit në 107.159.114 euro.⁹⁵ Fitim e humbur e qesin në mbi 140 milionë fitim të humbur.⁹⁶
129. I njëjti raport llogarit se Z Mobile ka fituar 73.180.742 euro deri në qershor 2019. Prej tyre, 31,178,920 euro janë nga vendimi i arbitrazhit, kurse 42,001,822 euro janë fitim bruto.
130. Sot fitimet e Z Mobiles ka gjasa të jenë të më larta se ç'janë pasqyruar në raportin e qershorit 2019. Telekomit tanimë ka shlyer rreth 11,5 milionë euro të dëmshpërblimit të arbitrazhit 2016 — 4,5 milionë sipas Ujdisë së majit 2017 dhe rreth 7 milionë nga 27-përqindëshi i papa-

92 Shtojca 40: Prezantimi i dëmeve, f. 22, 27–28.

93 Shtojca 39: Raporti i dëmeve; Shtojca 40: Prezantimi i dëmeve.

94 **Shtojca 7:** Auditimi 2018, f. 9–10.

95 Shtojca 40: Prezantimi i dëmeve, f. 13.

96 Po aty, f. 2, 13; Shtojca 39: Raporti i dëmeve, f. 3.

guar. Kurse gjykata ka njohur borxhin prej gati 25 milionë eurosh të tjera. Kështu Z-ja nxjerr afro 36,5 milionë euro prej arbitrazhit. Kur shtohet edhe fitimi nga operimet prej qershorit në nëntor 2019, totali i profitit mbërrin në 83 milionë euro. Në anën tjetër, humbjet e Telekomit shkojnë në rreth 263 milionë euro. (Këto përlllogaritje i kemi shtjelluar në pjesën VI.B të kësaj parashtrese.)

131. Në konkludim, Z Mobile ka bërë palë milionat që do duhej t'i takonin Telekomit. Ndërmarrja publike, që dikur jepte 200 milionë euro dividendë vjetore, tani po përpëlitet për mbijetesë. Kurse punëtorët e saj — të cilët i përfaqëson paditësja — rrezikojnë kafshatën e gojës.
132. Një industri e tërë, që përfshin partnerët komercialë të Telekomit por dhe konkurrentët, rrezikon të përmbysset nga Marrëveshja e keqe e janarit 2009.

V. SHKELJET LIGJORE

A. Baza ligjore për nulitetin

Nuliteti në përgjithësi — LMD

133. Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (LMD) përbën bazën ligjore për lidhjen e kontratave në Kosovë. Neni 89 parasheh nulitetin apo pavlefshmërinë e kontratës si vijon:

Kontrata që është në kundërshtim me rendin publik, dispozitat urdhëruese, ose moralin e shoqërisë është nule, në qoftë se qëllimi i rregullës së cenuar nuk udhëzon në ndonjë sanksion tjetër apo në qoftë se ligji në rastin e caktuar nuk parashikon diç tjetër.⁹⁷

134. Rregull të ngjashme parasheh Ligji i vjetër mbi marrëdhëniet e detyrimeve i 1978-ës, që ka qenë në fuqi në kohën kur është lidhur Marrëveshja mes Valës e Z Mobiles:

Kontrata që është në kundërshtim me parimet e përcaktuara me kushtetutë të rregullimit shoqëror me dispozitat e detyrueshme apo me moralin e shoqërisë vetëqeverisëse socialiste është nul, në qoftë se qëllimi i rregullës së shkelur nuk pasjell ndonjë sanksion tjetër apo në qoftë se ligji në rastin e caktuar nuk parashikon diçka tjetër.⁹⁸

135. Ligji e njeh mundësinë edhe të nulitetit të pjesshëm:

Nuliteti i ndonjë dispozite të kontratës nuk mund të ketë si pasojë nulitetin edhe të vetë kontratës, në qoftë se ajo mund të qëndrojë pa dispozitën nule, dhe në qoftë se ajo nuk ka qenë kusht apo motiv vendimtar për lidhjen e saj.⁹⁹

136. Sa u përket pasojave, ligji thotë:

Në rastin e nulitetit të kontratës secila palë kontraktuese ka për detyrë t'ia kthej palës atë që ka marrë në bazë të kontratës së tillë, e në rast se kjo është e pamundshme apo nëse kthimi parandalohet nga natyra e asaj që është plotësuar, duhet të bëhet kompensimi përkatës në të holla sipas çmimeve në kohën e

97 Neni 89.1.

98 LMDJ, neni 103.1.

99 LMD, neni 91.1; shih dhe LMDJ, neni 105.

nxjerrjes së vendimit gjyqësor, përveç nëse përcaktohet ndryshe me ligj.¹⁰⁰

137. Komentari i LMD-së shpjegon:

Përmes pasojave juridike të nulitetit të kontratave pengohet ndikimi i atyre kontratave që kanë aso mungesash që i bëjnë të jenë në kundërshtim me rendin publik. Ligjvënësi ynë jep klaufuzolën e përgjithshme, sipas së cilës kontrata që është në kundërshtim me rendin publik, dispozitat urdhëruese ose me moralin e shoqërisë është nule, në qoftë se qëllimi i rregullës së cënuar nuk udhëzon në ndonjë sanksion tjetër apo në qoftë se ligji në rastin e caktuar nuk parashikon diç tjetër.¹⁰¹

Rendi publik, dispozitat urdhëruese, morali — E drejta vendase

138. E drejta vendase nuk përkufizon dispozitat urdhëruese, rendin publik dhe moralin e shoqërisë, që përbëjnë bazën për nulitetin e kontratës. Këtë s’e japin as ligji, Komentari, shkrimet e tjera të juristëve as praktika gjyqësore. Por e drejta vendase lë të kuptohet se të tri konceptet mund të shihen si një tërësi apo një koncept i vetëm.

139. LMD i përdor të tri termat në nenin 89, por nuk i përkufizon ato. LMD i vjetër thirret shprehimisht në parimet kushtetuese.¹⁰²

140. Sa i përket rendit publik, Komentari thotë:

Kemi të bëjmë me kundërshtim të rendit publik kur palët kontraktuese parashikojnë me kontratë monopolin e tregut mbi ndonjë prodhim, gjë që është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Tregtinë e Lirë në Kosovë. Po ashtu, kur bankat, p.sh., merren vesh mes vete për normat e interesit mbi kreditë e dhëna klientëve të tyre, një marrëveshje e tillë është në kundërshtim me rendin publik etj.¹⁰³

141. Akademikët vendas flasin në përgjithësi për një tërësi të rregullave të rendit juridik:

[R]regullat e rendit juridik në të cilat hyjnë dispozitat ligjore, rregullat morale, rregullat zakonore paraqiten si numërues të

100 LMD, neni 90.1; shih LMDJ, neni 104.

101 Komentari, sipër në shënimin 13, neni 89, kmt. 1, f. 104 (citimet janë hequr).

102 LMDJ, neni 103.1.

103 Po aty, kmt. 1(a).

përbashkët për kontratat e ndaluara. Çdo tërësi sikundër janë rregullat e rendit juridik, dispozitat ligjore, rregullat e moralit, doket e mira, në qoftë se të gjitha cenohen, shpallin kontratën e ndaluar.¹⁰⁴

142. Praktika gjyqësore në vend është e varfër sa i përket nulitetit të kontratave. Shumica e rasteve të evidentuara kanë të bëjnë me çështje pronësore.¹⁰⁵ Nga raste të tjera, akademikët japin si shembuj të kontratave nule rastet kur «një grup njerëzish privilegohet sepse lejohet që ata të blejnë [mall] me *çmim më të ulët se sa që është çmimi në treg*»,¹⁰⁶ si dhe marrëveshjet «në kundërshtim me doket e mira afariste» që lejojnë blerësin të shfrytëzojë sendin pa e paguar çmimin vetëm pse s'janë sanuar disa mangësi.¹⁰⁷
143. Si përmbyllje, nga mënyra si janë trajtuar në jurisprudencën tonë, nxjerrim se dispozitat urdhëruese, rendi publik dhe morali i shoqërisë përbëjnë një tërësi ose terma praktikisht të ndërkëmbyeshëm.
144. Por shkrimet e akademikëve na sugjerojnë se këto koncepte kanë burim në të drejtën e huaj.¹⁰⁸ Rrjedhimisht, orientohemi edhe në literaturën ndërkombëtare dhe praktikën e gjykatave të huaja për të gjetur përkufizime dhe shembuj të dispozitave urdhëruese, rendit publik dhe moralit të shoqërisë.

Rendi publik, dispozitat urdhëruese, morali — E drejta e huaj

145. As e drejta e huaj nuk jep përkufizime të qarta për tri termat. Por na lejon t'i kuptojmë si parime të gjera e të mirëpranuara që i shërbejnë drejtësisë, «pa marrë parasysh bindjet fetare a filozofike».¹⁰⁹ Gjith-

104 Alajdin Alishani, *E drejta e detyrimeve (pjesa e përgjithshme)* (Enti KSAK: Prishtinë, 1985), f. 327.

105 Shih, p.sh., rastet PZ-C-907/11 e PZ-C-152/14; Përmbledhje nga praktika e Gjykatës Supreme në kontestet pronësore (Prishtinë, 2019), f. 78; Buletini i praktikës gjyqësore i Gjykatës së Apelit të Kosovës (Prishtinë, 2016), f. 35.

106 Alishani, sipër në shënimin 104, f. 325 (citon ZSO knjiga 9, sveska 1, br. 26, Beograd, 1963 RVSJ rev. 3635/63, od. 1.01.1964; theksim i shtuar).

107 Po aty, f. 326–27 (citon ZSO knjiga 18, sveska 2, 1973, Beograd, 1975, br. 230, f. 278–280).

108 Po aty, f. 327.

109 B. Fauvarque-Cosson & D. Mazeaud, eds., *European Contract Law: Materials for a Common Frame of Reference: Terminology, Guiding Principles, Model Rules* [E drejta evropiane e kontratave: Materiale për një kornizë të përbashkët referimi: Terminologjia, parimet udhëzuese dhe rregullat model] (Sellier 2008), f. 123

ashtu, mbështet qasjen e thjeshtuar që sheh dispozitat urdhëruese, rendin publik dhe moralin e shoqërisë si koncepte të pandashme.¹¹⁰

146. Terminologjia ndërkombëtare është e larmishme. Për shembull, rendi publik njihet frëngjisht si *ordre public*,¹¹¹ anglisht *public policy* (politikë publike) e gjermanisht si *Sittenwidrigkeit*.¹¹² Përveç kësaj, një ligj gjerman flet për *guten Sitten* (moralin),¹¹³ por e përdor për të mbuluar edhe rrethana që në vende të tjera futen nën termin rend publik.¹¹⁴ Kjo laramani e ngatërron më tej kuptimin e saktë të fjalëve.
147. Literatura sugjeron se ka dallime nuancore mes dispozitave urdhëruese, rendit publik dhe moralit të shoqërisë, sado që dallimet të jenë të përshkëllira.¹¹⁵ Por për qëllime praktike, ato mund të shihen si një tërësi. Për këtë arsye, do t'u referohemi shkurt si rend publik ose si moral.
148. Nuk ka rregulla të prera se çka cenon rendin publik a moralin. Por praktika gjyqësore rëndom ndjek rrethanat shoqërore të kohës.¹¹⁶ Kjo ndodh veçanërisht në shtetet që çmojnë ekonominë e tregut dhe autonominë e palëve kontraktuese.
149. Veçmas, dallohet praktika gjyqësore gjermane që e lidh moralin me parimet kushtetuese, të vendosura me Ligjin Themelor të pas-Luftës së Dytë Botërore.¹¹⁷
150. Akademikët gjithashtu njohin si cenim të moralit sjelljet jolegjitime ndaj palës kontraktuese, ndaj komunitetit në tërësi, si dhe ndaj palëve të treta.¹¹⁸

(citimet janë hequr).

110 Shih po aty, f. 101–149.

111 Kodi civil francez, *Code civil*, neni 6.

112 Kodi civil gjerman, BGB, neni 138.

113 BGB, neni 138.1.

114 B. Fauvarque-Cosson & D. Mazeaud, sipër në shënimin 109, f. 127.

115 Shih, p.sh., Académie de droit international, *Recueil des cours: Collected courses of the Hague Academy of International Law* [Përmbledhje kursesh nga Akademia e Hagës e së Drejtës Ndërkombëtare], 1981, III, Tome 172 (Martinus Nijhoff: Hague, 1982), f. 239; Monika Pauknerová, «Mandatory rules and public policy in international contract law» [Rregullat e detyrueshme dhe rendi publik në të drejtën ndërkombëtare të kontratave], *ERA Forum* (2010) 11, f. 29–43.

116 Markesinis etj., *The German Law of Contract: A Comparative Treatise* [E drejta gjermane e kontratave: Tekst krahasimor], 2d ed. (Hart, 2006), f. 249 (citon *Nagle v. Feilden* [1966] 2 QB 633, 650).

117 B. Fauvarque-Cosson & D. Mazeaud, sipër në shënimin 109, f. 127.

118 Markesinis, sipër në shënimin 116, f. 254.

151. Në fund, vetë koncepti i moralit, doket e zakonet, të drejtat dhe liritë themelore, normat që kanë për qëllimet zhvillimin e shoqëritë dhe parimet kushtetuese — të gjitha këto, thonë akademikët — përbëjnë parimet ose vlerat që përfaqëson rendi publik.¹¹⁹

B. Marrëveshja cenon parimet kushtetuese mbi rendin ekonomik

152. Marrëveshja mes Telekomit e Z Mobiles është e pavlefshme sepse ndryshon parimet e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Këto shkelje cenojnë rendin publik dhe moralin, në kuptimin e nenit 89 të LMD-së dhe nenit 103 të LMD-së së vjetër.

153. Neni 119 i Kushtetutës parasheh disa parime të rendit ekonomik.

154. Paragrafi 4 flet për mirëqenien e qytetarëve dhe zhvillimin e qëndrueshëm:

Republika e Kosovës promovon mirëqenie për të gjithë qytetarët e saj duke inkurajuar zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.

155. Paragrafi 9 kërkon prajshmëri në drejtimin e ndërmarrjeve publike:

Republika e Kosovës ushtron të drejtën e pronësisë mbi çdo ndërmarrje që ajo kontrollon në pajtim me interesin publik, me qëllim që të maksimalizojë vlerën afatgjate të ndërmarrjes.

156. Thelbin e paragrafit 9 e gjejmë edhe në Ligjin për ndërmarrjet publike, që veçmas e detyron bordin e drejtorëve të veprojë për të rritur ndërmarrjen dhe të marrë vendime sipas ligjit dhe orientimeve strategjike.¹²⁰ Në çdo kohë, bordi duhet të veprojë me ndershmërinë e besnikërinë më të lartë ndaj ndërmarrjes dhe në interesin më të mirë të saj.¹²¹

157. Dispozita të tjera të nenit 119 të Kushtetutës mbrojnë konkurrencën e lirë dhe konsumatorët.¹²² Kurse neni 125, mes të tjerash dispozita, kujdeset për sigurinë publike dhe kombëtare.

¹¹⁹ Cemal Şanlı etj., *Milletlerarası Özel Hukuk* [E drejta ndërkombëtare private], 2. bası (Vedat Kitapçılık: İstanbul, 2014), f. 123.

¹²⁰ LNP, neni 12.

¹²¹ LNP, në shumë nene, përdor termin *detyra fiduciare* (të besuara). Ky term është huazuar nga anglishtja. Shih zërin *fiduciary duty* në fjalorin juridik *Black's Law Dictionary*, 9th ed., f. 581.

¹²² Neni 119, para. 3 dhe 7.

158. Bordi i Telekomit ka shkelur veçanërisht nenin 119.9 dhe detyrimet nga Ligji për ndërmarrjet publike kur ka shpërfillur këshillën e ekspertëve kundër Marrëveshjes me Z Mobilen. Kështu është vënë në pikëpyetje qëndrueshmëria e një ndërmarrjeje të rëndësishme publike. Njëherësh, janë rrezikuar Forca e Sigurisë e Kosovës, Policia, Agjencia e Inteligjencës, zjarrfikësit, institucionet arsimore, agjencitë për reagim ndaj emergjencave dhe organe të tjera publike e kushtetuese që varen nga infrastruktura e Telekomit.
159. Si ndërmarrje publike në një shtet në transicion, Telekomit përbën person të cenueshëm, përkundër burimeve financiare e njerëzore që ka pasur ndër dekada. Banka Botërore ka përdorur termin «kapje e shtetit» (*state capture*) për të përshkruar korrupsionin politik në ish-vendet socialiste, ku pushtetarët kontrollojnë vendimmarrjen për interesa të tyre. Literatura vëren se oligarkët rëndom shënjestrojnë ndërmarrjet publike, duke emëruar njerëzit e vet në pozita drejtuese, për përfitime përmes prokurimit dhe kontratave komerciale.¹²³ Ndërrimi i shpeshtë i udhëheqjes së Telekomit në kohën e Marrëveshjes, negociatat me kontestuar dhe vendimmarrja e keqinformuar — të gjitha këto flasin për një kontratë simptomë të shtetit të kapur, në vend të një veprimi në të mirë të ndërmarrjes dhe të interesit publik.
160. Ashtu si në rastet gjermane që vërtetojnë pavlefshmërinë e kontratave kur cenojnë parimet kushtetuese, edhe Marrëveshja Telekomit–Z Mobile ndryshon nenin 119 e 125 të Kushtetutës sonë. Ndonëse për disa nga parimet e nenit 119 ekzistojnë mjete juridike të veçanta,¹²⁴ shkeljet në rastin tonë janë më të gjera dhe mund të trajtohen vetëm përmes vendimit të gjykatës. Për më tepër, Marrëveshja shkel edhe Ligjin për ndërmarrjet publike. Kësisoj, kontrata mes dy operatorëve telefonikë cenon rendin publik, dispozitat urdhëruese dhe moralit të shoqërisë, dhe është juridikisht nule apo e pavlefshme.

123 Banka Botërore, *Anticorruption in Transition: A Contribution to the Policy Debate* [Antikorrupsioni në transicion: Kontribut në debatin e politikëbërjes] (World Bank: Washington, D.C., 2000), bit.ly/3j8WOjo, f. 9.

124 Shih, p.sh., Ligjin 03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës, GZRK 88/2010, ndryshuar me ligjin 04/L-226, GZRK 17/2014; Ligjin 04/L-121 për mbrojtjen e konsumatorit, GZRK 11/2018.

C. Marrëveshja lejon dënime të shumëfishta kontraktore — masë plaçkitëse në kundërshtim me vendimet e Kushtetueses e Supremes dhe dispozitat urdhëruese të LMD-së

161. Sistemi civil në Evropë i trajton ndëshkimet e shumëfishta si pengesë të rendit publik. Dëmshpërblimet ndëshkuese nuk lejohen për përgjegjësinë jashtëkontraktore mu pse shihen si në kundërshtim me rendin publik.¹²⁵ Kurse te kontratat, pala mund të kërkojë:
- (1) përmbushjen e detyrimit ose dëmshpërblimin për mospërmbushjen,¹²⁶ por jo të dyja; dhe
 - (2) fitimin e humbur sipas ligjit për shkak të vonesës ose dënimit e përcaktuar me marrëveshje për rast vonese, cilado shumë të jetë më e lartë, por jo të dyja.¹²⁷
162. Dëmet e likuiduara, që janë një lloj ndëshkimi kontraktor, nuk njihen në legjislacionin kosovar. Kurse ndalohet shprehimisht kamata mbi kamatë.¹²⁸ Përfundimisht, duhet kthyer sendet e fituara nga pasurimi i pabazë dhe puna juridike e pavlefshme.¹²⁹
163. Ndalimin e ndëshkimeve të shumëfishta — një lloj fajdeje — e konfirmon në Kosovë jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Supreme.¹³⁰ Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë efekt *erga omnes*, që i bie se janë detyruese ndaj të gjithëve.¹³¹ Kurse vendimet e Gjykatës Supreme, që njëson interpretimin e ligjit dhe praktikën gjyqësore, duhet të udhëzojnë vendimmarrjen e të gjithë gjyqësorit të rregullt.
164. Në rastin e bankës Raiffeisen më 2014, Gjykata Kushtetuese la në fuqi aktgjykimin e Gjykatës Supreme që ndalonte kamatën ndëshkuese mbi detyrimet në të holla.¹³² Në këtë rast, Gjykata Supreme kishte zbatuar

125 Rregullore nr. 864/2007 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, e 11 korrikut 2017, mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet jokontraktore (Rome II), OJ L 199/40, preambula, para. 32.

126 LMD, shih nenet 106 dhe 137.

127 LMD, nenet 259–260; LMDJ, nenet 275–276.

128 LMD, neni 379.

129 LMD, nenet 194.1 dhe 90.1.

130 Rasti *Raiffeisen*, KI 118/14, GjK, Aktvendim 9.3.2015 (vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjyk. E. Rev. nr. 24/2013, GjS, 5.2.2014).

131 Kusht., neni 116.1.

132 Rasti KI 118/14, Aktvendim, para. 80.

dispozitat e LMD-së,¹³³ që nuk lejojnë kamatë në kamatë, si një formë e ndëshkimeve të shumëfishta.

165. Juristët e huaj i quajnë plaçkitëse (*spoliating*) ndëshkimet e tilla.¹³⁴ Ato nuk lejohen në vende pro biznesit si Austria, Zvicra e Gjermania.¹³⁵ Por Marrëveshja ka mundësuar pikërisht plaçkitjen, duke e detyruar Telekomin:

- (1) t'i japë Z Mobiles numra, kartela e qasje në rrjet pa kufizim në sasi a kohë; dhe
- (2) t'i paguajë Z Mobiles si dëmshpërblim dënime kontraktore, fitimin e humbur, dënime ditore, e pagesa të tjera në vlerë prej miliona eurosh.

166. Më hollësisht, Telekomit detyrohet:

- (1) t'i përmbushë detyrimet ndaj Z Mobiles — pa kufizim në sasi dhe në kohë:
 - (a) ndarjen e numrave;
 - (b) ndarjen e kartelave sim; dhe
 - (c) ofrimin e qasjes në 3G dhe 4G;
- (2) t'i paguajë Z Mobiles si dëmshpërblime:
 - (a) kompensimin e dëmeve të likuiduara për vonesa në lartësi prej 8.785.000 eurosh, plus kamatën prej 8 për qind;
 - (b) kompensimin e fitimit të humbur në lartësi prej 17.315.000 eurosh, plus kamatën prej 8 për qind;
 - (c) kompensim nga 5.000 euro të dëmeve të likuiduara (dënim ditor) për çdo ditë vonese në përmbushjen e secilit detyrim, gjithsej deri në 17.315.000 euro; dhe

133 Shih LMDJ, neni 270–277.

134 Hilmar Raeschke-Kessler, «Recent Austrian, German, and Swiss Judicial Decisions Involving International Arbitration» [Raste të reja gjyqësore nga Austria, Gjermania e Zvicra lidhur me arbitrazhin ndërkombëtar], në Arthur Rovine, ed., *Contemporary Issues in International Arbitration and Mediation: The Fordham Papers 2008* [Çështje bashkëkohore në arbitrazhin dhe ndërmjetësimin ndërkombëtar: Punimet e Fordhamit 2008] (Martinus Nijhoff, 2009), f. 132.

135 Po aty.

(d) shpenzimet e procedurës së arbitrazhit në lartësi prej 972.121,22 eurosh dhe 534.000,00 dollarësh amerikanë.¹³⁶

167. Veçmas, dëmet e likuiduara janë llogaritur si dëm i rëndomtë — pra, dëm i mospërbushjes — ani pse ato janë ndëshkime për vonesën. Në këtë rast, Z Mobile është dashur të zgjedhë mes ndëshkimeve ose fitimit të humbur, dhe ka mundur të zgjedhë shumën më të lartë prej 17.315.000 eurosh (përkundër përlllogaritjes së padrejtë edhe të kësaj shume). Por nuk ka mundur t'i shtojë 8.785.000 euro të tjera. Sepse në thelb kjo është një lloj kamate mbi kamatë, dhe përbën plaçkë.
168. Ngjashëm paraqesin shqetësim penalet prej 5.000 në ditë vonese. Të vetëdijshëm se po i tejkalojnë kufijtë e ligjit kosovar, arbitrat mundohen të vënë një maksimum: dënimet ditore nuk mund ta kalojnë shumën e fitimit të humbur, të caktuar edhe ashtu padrejtësisht në lartësi prej 17.315.000 eurosh.¹³⁷ Por ky është thjesht kamuflim. Ligji lejon me zgjedhë mes fitimit të humbur e dënimeve, varësisht se cili opcion jep më shumë. Por nuk lejon me i bashku të dyja, e as nuk parasheh kamatën mbi ndëshkime. Këtu Z Mobile i merr të gjitha shumëfish, duke u pasuruar pa bazë.
169. Në fund, sa i përket detyrimit të pakufizuar për furnizim me numra dhe kartela, Marrëveshja paraqet elemente të objektit të pamundshëm.¹³⁸ Numeracioni dhe kartelat e telefonisë mobile janë burim i kufizuar.
170. Parë në tërësi, Marrëveshja e ka detyruar Telekomin të përmbushë detyrime të shumëllojta dhe të paguajë shumëfish shpenzimet e procedurës dhe përfaqësimit, kompensimin e dëmit të rëndomtë, dëmet e likuiduara, fitimin e humbur, penalltitë ditore, si dhe kamatën mbi të gjitha këto pagesa. Ligji ynë nuk lejon ndëshkime të tilla të shumëfishta në asnjë rrethanë.
171. Prandaj, kjo Gjykatë e nderuar duhet ta njohë si kontratë nule Marrëveshjen Telekom-Z Mobile. Marrëveshja cenon rendin publik, duke lejuar plaçkitjen e një ndërmarrjeje publike — shtëpisë së 2.360 punëtorëve — që tashmë veç ndodhet në prag të rrënimit.

¹³⁶ Shtojca 16: Vendimi përfundimtar i arbitrazhit, dispozitivi, VI.

¹³⁷ Po aty, dispozitivi, VI.4.

¹³⁸ Shih LMD, neni 35.

D. Marrëveshja cenon dispozitat urdhëruese dhe moralin, duke lejuar sjellje jolegjitime ndaj palës dhe komunitetit

172. Autoritetet e së drejtës së detyrimeve flasin për pavlefshmërinë e kontratave që cenojnë interesat e njëjës palë, por dhe komunitetit në tërësi.¹³⁹
173. Vetë ligji kosovar njih si parime të marrëdhënive të detyrimeve ndër-gjegjshmërinë dhe ndershmërinë,¹⁴⁰ kujdesin e një shtëpiaku të mirë,¹⁴¹ si dhe moskeqpërdorimin e të drejtave.¹⁴² Palët nuk mund t'i shmangin me kontratë këto parime,¹⁴³ dhe veçmas nuk u lejohej me ndërmarrë veprime që tjetrit ia vështirësojnë punën ose e dëmtojnë.¹⁴⁴ Me fjalë të tjera, parimet e marrëdhënive të detyrimeve janë dispozita urdhëruese.
174. Duke shfrytëzuar kontratën me Telekomin, Z Mobile qysh në vitet e para është përfshirë në sjellje të pandërgjegjshme ndaj të tjerëve. Të tilla janë mashtrimet me kartelat sim, që u shkaktojnë humbje milionëshe operatorëve telefonikë. Ndaj mashtrimeve kanë reaguar Telekom i Monakos dhe Zyra Kombëtare e Auditimit.¹⁴⁵ Por Telekom i Kosovës, si palë e Marrëveshjes së 2009-ës, nuk është se ka marrë ndonjë masë.
175. Tutje, Z Mobile ka vijuar ta mbingarkojë rrjetin e Telekomit të Kosovës, duke i cenuar — përmes Marrëveshjes së 2009-ës — interesat e Telekomit, interesat e konsumatorëve, partnerëve dhe punonjësve të Telekomit, por dhe të operatorëve të tjerë dhe klientëve të tyre.
176. Në fund, Marrëveshja e 2009-ës bie ndesh me doket e mira dhe standardet e tregut duke e quajtur Z Mobilen operator virtual, duke i shitur shërbime nën çmimin e tregut botëror dhe duke bërë biznes pa garancë të mirëfilltë bankare. Z Mobile nuk është operator, por thjesht rishitës.

139 Markesinis, sipër në shënimin 116, f. 254.

140 LMD, neni 4.

141 LMD, neni 5.

142 LMD, neni 6.

143 LMD, neni 4.2.

144 LMD, neni 6, para. 2–3.

145 Shih sipër, para. 65.

Këto mangësi i ka konstatuar vetë eksperti i angazhuar prej Z Mobiles.¹⁴⁶

177. Ndonëse për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe të konsumatorëve ekzistojnë mjete të tjera juridike, konkurrenca dhe konsumatorët janë vetëm dy elemente nga një mori shkeljesh që vihen re në këtë rast. Andaj, Gjykata e nderuar mund t'i ketë parasysh për të konstatuar sjelljen jolegjitime të Z Mobiles ndaj Telekomit dhe të Z Mobiles e Telekomit bashkë ndaj komunitetit në tërësi.
178. Për këto arsye, Gjykata duhet të konstatojë se Marrëveshja shkel dispozitat urdhëruese dhe moralin e shoqërisë, dhe kështu ka qenë nule që nga dita e nënshkrimit.

146 Shih sipër, para. 74 e tutje.

VI. DËMET

A. Baza ligjore

179. Ligji për marrëdhëniet e detyrime parasheh që secilës palë t'i kthehet sendi i marrë përmes kontratës së pavlefshme. Neni 90 përcakton:

1. Në rastin e nulitetit të kontratës secila palë kontraktuese ka për detyrë t'ia kthej palës atë që ka marrë në bazë të kontratës së tillë, e në rast se kjo është e pamundshme apo nëse kthimi parandalohet nga natyra e asaj që është plotësuar, duhet të bëhet kompensimi përkatës në të holla sipas çmimeve në kohën e nxjerrjes së vendimit gjyqësor, përveç nëse përcaktohet ndryshe me ligj.

2. Në rast se kontrata është nul për shkak se sipas përmbajtjes ose qëllimit të vet është në kundërshtim me parimet themelore morale, gjykata mund të refuzojë tërësisht ose pjesërisht kërkesën e palës së pandërgjegjshme për kthimin e asaj që i ka dhënë palës tjetër; në marrjen e vendimit, gjykata do të ketë parasysh shkallën e veprimit në mirëbesim të njëres ose të të dy palëve dhe rëndësinë e interesave që cenohen.

180. Sipas ligjit, të dëmtuarit i takon shpërblimi për dëmin e rëndomtë dhe fitimin e humbur.¹⁴⁷

181. Ndonëse ligjërisht e pavlefshme, Marrëveshja mes Telekomit dhe Z Mobiles në përgjithësi nuk ka përmbajtje ose qëllim të ndaluar. (Si objekt i pamundshëm mund të cilësohet, megjithatë, detyrimi i pakufizuar për numra e kartela.) Rrjedhimisht, Z Mobile detyrohet t'ia kthejë Telekomit fitimin e nxjerrë nga Marrëveshja si dhe ta kompensojë për dëmin e rëndomtë dhe fitimin e humbur si pasojë e Marrëveshjes.

B. Llogaritja

182. Ekspertët brenda Telekomit kanë llogaritur se Z Mobile ka fituar plot 73.180.742 euro deri në qershor 2019, duke arkëtuar mbi 52 milionë syresh. Ndërsa dëmet e Telekomit i vlerësojnë në 107.159.114 euro humbje reale dhe mbi 140 milionë euro fitim të humbur.¹⁴⁸

183. Përllogaritjet që jep raporti i ekspertëve janë konservative.

¹⁴⁷ LMD, neni 173.

¹⁴⁸ Shih sipër para. 128 e tutje të kësaj padie.

184. Së pari, Z Mobile ka gjasa të nxjerrë disa milionë më shumë nga vendimi i arbitrazhit. Të paktën 4,5 milionë euro do të jenë paguar sipas Ujdisë jashtëgjyqësore gjatë verës së 2017-ës,¹⁴⁹ dhe mbi 7 milionë të tjerë do të jenë shlyer nga mospagimi i 27-përqindëshit që prej vitit 2016.¹⁵⁰ Kurse gjykata tani ka lejuar përmbarrimin e borxhit prej gati 25 milionë euro nga vendimi i arbitrazhit. Kështu totali i arbitrazhit sillet te rreth 36,5 milionë euro, gati 6 më shumë se ç’thuhet në raport. Kur ua shtojmë këtë shumë fitimit dhe humbjeve të palëve, nxjerrim këto shifra për qershorin 2019: 79 milionë euro fitim për Z Mobilen dhe 253 milionë euro humbje për Telekomin.
185. Së dyti, raporti nuk llogarit fitimin dhe humbjen e palëve në pesë muajt e fundit të operimit të rrjetit virtual, nga qershori në nëntor 2019. Nga janari 2009 deri në qershor 2019, janë plot 126 muajt: mesatarisht 615 mijë euro fitim për Z Mobilen dhe 2 milionë euro humbje për Telekomin. Nëse ia shtojmë totalit pesë muajt e fundit, përftojme: **84 milionë euro fitim për Z Mobilen dhe 263 milionë euro humbje për Telekomin.**
186. Paditësja — si palë e tretë, e pa përfshirë në transaksionet që janë objekt shqyrtimi — nuk është tani në gjendje të llogaritë dëmet me përpikëri. Por ruan të drejtën për të saktësuar dëmet e shkaktuara ndaj saj, ndaj Telekomit dhe ndaj palëve të treta, përmes sigurimit të provave dhe ndihmës së ekspertëve.

149 Shtojca 2: Ujdia jashtëgjyqësore, neni 3.1.

150 Llogaritur sipas mesatares vjetore të 27-përqindëshit: për rreth 7 vjet janë paguar mbi 14 milionë. Shih Prezantimin e dëmeve, f. 10.

VII. MASAT E SIGURIMIT

187. Tutje, paditësja i propozon Gjykatës së nderuar të vendosë masa të sigurimit kundër dëmeve të mëtejme. Veçmas, kërkon masa që nga tani deri në shqyrtimin përfundimtar të padisë:
- (1) e pengojnë Z Mobilen të pranojë mjete nga Telekomit ose aksionari i Telekomit;
 - (2) ia ndalojnë Z Mobiles të negociojë kontratë të re ose të vazhdojnë Marrëveshjen me Telekomin;
 - (3) e pengojnë Z Mobilen të fshehtë pasuritë kyçe.
188. Paditëse-propozuesja lut Gjykatën që masat e sigurimit **t'i vendosë menjëherë si masa të përkohshme**, ende pa njoftuar dhe dëgjuar palët. Çështja për paditëse-propozuesen është ekzistenciale: përmbartimi i dëmshpërblimit të arbitrazhit prej gati 25 milionë euro mund të sjellë falimentimin e Telekomit, duke lënë pa punë 2.360 punëtorët dhe anëtarët e Sindikatës. Shkaku i Telekomit, cenohet edhe siguria shtetërore.
189. Një kontratë si Marrëveshja e 2009-ës do të rrezikonte gjithashtu falimentimin e Telekomit dhe do të shkaktonte dëm të pariparueshëm për sektorin e telekomunikacionit në vend. Madje, do të përbënte kontratë me fajde. Në anën tjetër, Z Mobile do ta vështirësonte kompensimin e dëmit nëse tjetëron a fshehtë pasurinë e vet dhe njëherësh vijon të arkëtojë nga Telekomit pagesa të borxhit prej vendimit të arbitrazhit ose borxheve të tjera.

A. Baza ligjore

190. Ligji për procedurën kontestimore lejon me vendosë masë të sigurimit nëse:
- a) [...] propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij, dhe
 - b) [...] ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzis-

tuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.¹⁵¹

191. Gjykata mund ta vendosë masën e sigurimit pa garanci për dëmet që mund t'i shkaktojë masa, nëse propozuesi nuk është në gjendje ta paguajë garancinë.¹⁵²

192. Ligji lejon këto masa, ndër të tjera, për të ruajtur gjendjen ekzistuese:

a) ndalimi kundërshtarit të sigurimit që t'i kryejë aktivitetet e caktuara, po urdhri që t'i kryejë aktivitetet e tilla, me qëllim të ruajtjes së gjendjes ekzistuese apo pengimit të dëmtimit të palës kundërshtare;

[...]

c) lënia e pasurisë së caktuar të kundërshtarit të sigurimit për ruajtje dhe përkujdesje personit të tretë;

d) dhe masa tjera të cilat i cakton gjykata si të domosdoshme për sigurimin e kërkesëpadisë së propozuesit të sigurimit.¹⁵³

193. Sa u përket kërkesave në të holla, ligji parasheh këto masa, ndër të tjera:

a) ndalimi kundërshtarit të sigurimit që ta tjetërsojë, fshehtë, ngarkojë ose disponojë me pasurinë e caktuar me vlerë të mjaftueshme për sigurimin e kërkesës së propozuesit të sigurimit. Ky ndalim do të regjistrohet në regjistrin publik përkatës;

[...]

c) ndalimi debitorit të kundërshtarit të sigurimit që këtij të fundit t'i përmbushet kërkesa apo dorëzohet sendi, si dhe ndalimi kundërshtarit të sigurimit që ta pranojë sendin, ta realizojë kërkesën apo të disponojë me të;

[...].¹⁵⁴

194. Me kërkesën e propozuesit, gjykata mund të vendosë masat menjëherë pa ftuar palët në seancë, nëse «propozuesi i sigurimit e bënë të besue-

151 LPK, neni 297.1.

152 LPK, neni 297.3.

153 LPK, neni 301.

154 LPK, neni 299.1.

shëm pretendimin se masa e sigurimit është e bazuar dhe urgjente dhe se me veprim ndryshe do të humbte qëllimi i masës së sigurimit».¹⁵⁵

B. Arsyetimi

195. Gjykata e nderuar duhet ta vendosë masa të sigurimit në këtë rast, meqë propozuesja ka përmbushur kushtet ligjore.

Besueshmëria e padisë

196. Së pari, ka parashtruar argumente të besueshme për pavlefshmërinë e Marrëveshjes Telekomit–Z Mobile. Marrëveshja cenon parimet kushtetuese, shkel dispozitat e LMD-së, si dhe dëmton palët e treta. Gjithashtu, propozuesja ka paraqitur prova të besueshme për dëmet që ka shkaktuar Z Mobile.

Rreziku i dëmit të pariparueshëm

197. Së dyti, propozuesja dëshmon rrezikun nga tre skenarë që u kanosen asaj dhe Telekomit:

- (1) përbarimi i borxhit prej gati 25 milionë eurosh në emër të vendimit të arbitrazhit të 2016-ës, që buron nga Marrëveshja;
- (2) kthimi në fuqi i Marrëveshjes me kërkesën e Z Mobiles ose lidhja e një kontrate të re me kushte të ngjashme; dhe
- (3) dëmshpërblime dhjetëra milionash për shkëputjen e Marrëveshjes ose moslidhjen e një kontrate të re me kushte të ngjashme.

198. Cilido skenar praktikisht do ta falimentonte Telekomin. Ringjallja e Marrëveshjes madje do t'i mundësonte Z Mobiles të fitojë pa djersë monopol mbi industrinë e telekomunikacionit në Kosovë, ndërkohë që do të dëmtonte rëndë konkurrencën dhe konsumatorët. Edhe nëse Telekomit formalisht i shpëton falimentimit, Telekomit do të shndërrohej në vasal të Z Mobiles.

199. Për më tepër, gjendja e rëndë financiare e Telekomit e vë Telekomin në pozitë të pabarabartë për të negociuar kontratë madhore. Z Mobile tani ka mundësi ta shfrytëzojë gjendjen e rënduar të Telekomit dhe ta detyrojë të lidhë ujdë ose kontratë me kushte tmerrësisht të pafavorsh-

155 LPK, neni 306.1.

me. Një marrëveshje e tillë njihet si kontratë me fajde dhe është e ndaluar sipas Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve.¹⁵⁶

200. Telekom i tashmë ka njoftuar Z Mobilen për skadimin e Marrëveshjes së 2009-ës. Por rreziku i një kontrate të re nuk është mënjanuar plotësisht, duke pasur parasysh detyrimet dhjetëra-milionëshe nga arbitrazhi i parë dhe procedurën e arbitrazhit të ri. Në këso rrethanash, Telekom i mund të rinisë negociatat për bashkëpunim me Z Mobilen.
201. Z Mobile tani e kupton se mund të përballet me drejtësinë dhe të detyrohet të paguajë kompensim për dëmet që ka shkaktuar. Për këtë arsye, ekziston rreziku i vetëkuptueshëm që Z Mobile të fshehë pasurinë e vet nga kreditorët, duke likuiduar asete që ka në Kosovë dhe duke bartur paratë e gatshme jashtë vendit.
202. Ndërkohë, nëse Telekom i detyrohet t'i shërbejë sërish Z Mobiles ose t'i kryejë ndonjë pagesë, situata do të ndehet shumëfish: Z Mobile do të kishte në dorë më shumë mjete për të fshehur nga kreditorët, Telekom i do t'i avitej falimentimit, ndërsa mbingarkesat do të rrezikonin me përmbysë rrjetin e telekomunikacionit në Kosovë.
203. Në këto rrethana, dëmi që do të pësonte Telekom i Kosovës dhe sektori i telekomunikacionit në Kosovë do të ishte i pariparueshëm. Dëm të rëndë do të pësonin veçmas 2.360 punëtorët e Telekomit, interesat e të cilëve i përfaqëson paditësja.
204. Për këto arsye, Gjykata duhet ta parandalojë dëmin e kanosur, duke caktuar masat e propozuara: ndalim i vazhdimet të Marrëveshjes, ndalim i negociatave për kontratë të re, ndalim i tjetërsimit të pasurisë dhe ndalim i përmbushjes së vendimit të arbitrazhit dhe të detyrimeve të tjera.

Lirimi nga garancia

205. Propozuesja paditëse e lut Gjykatën e nderuar që masat e sigurimit t'i vendosë pa kërkuar garanci. Propozuesja është organizatë jofitimprurëse, në shërbim të interesit publik, dhe nuk ka mjetet e nevojshme për të nxjerrë garancinë e paraparë me ligj. Rrjedhimisht, i kërkon Gjyka-

¹⁵⁶ LMD, neni 123; shih dhe nenin 7 (mbi ekuivalencën e prestimeve).

tës të konstatojë gjendjen financiare të propozueses dhe ta lirojë nga kushti i garancisë, sipas ligjit.¹⁵⁷

Domosdoshmëria për masë të përkohshme

206. Gjykata duhet të vendosë masat e sigurimit menjëherë sipas nenit 306.1 LPK. Përndryshe, përpjekjet e Z Mobiles për të vjelë borxhe nga Telekomit mund ta falimentojnë ndërmarrjen.
207. Masa e përkohshme e sigurimit është mënyra e vetme për të parandaluar një varg të këqijash për Republikën e Kosovës: të siguruar jetesën e mijëra punëtorëve të Telekomit, për të parandaluar çrregullimin shoqëror e ekonomik në një kohë ashtu të brishtë pandemie, për t'u dalë mburojë partnerëve dhe mbi 800 kreditorëve të ndërgjegjshëm të Telekomit, dhe për të mbrojtur industrinë e telekomunikacionit në vend.
208. Pa masa të përkohshme, rrezikojnë të bien komunikimet elektronike të institucioneve shtetërore, të cilat varen nga Telekomit i Kosovës për qasje në internet dhe për telefoninë fikse. Kështu cenohet siguria shtetërore dhe mjetet e punës së vetë gjyqësorit, Forcës së Sigurisë, Policisë, Agjencisë Kosovare të Inteligjencës, zjarrfikësve, agjencive për reagim ndaj emergjencave, dhe madje institucioneve shëndetësore që po luftojnë pandeminë.
209. Prandaj, paditëse-propozuesja, Sindikata e punëtorëve të Telekomit, vlerëson se ka dëshmuar urgjencën për masa të përkohshme dhe e lut Gjykatën që të nxjerrë menjëherë aktvendim për këtë qëllim.

C. Shuma e siguruar

210. Një raport i qershorit 2019 vlerësonte se i paditur-kundërpropozuesi Z Mobile kishte arkëtuar mbi 52 milionë euro fitim nga Marrëveshja me Telekomin. Fitimi i gjithsejtë arrinte në 73.180.742 euro. Sipas raportit, Telekomit kishte shënuar 107.159.114 euro humbje reale dhe mbi 140 milionë fitim të humbur.¹⁵⁸
211. Duke llogaritur përpjesëtimisht edhe muajt e operimit pas qershorit 2019 dhe luhatjen në dëmshpërblimin përfundimtar të arbitrazhit,

157 Shih LPK, neni 297.3.

158 Shih sipër para. 128 e tutje të kësaj padie.

nxjerrim këto shifra të rrumbullakuara: 83 milionë euro fitim për të paditurin dhe mbi 263 milionë euro humbje për Telekomin.¹⁵⁹

212. Propozuesja nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të përlllogaritur dëmet e palëve të treta nga Marrëveshja e paligjshme e 2009-ës. Gjithsesi, shuma e të hollave që duhet siguruar tejkalon vlerën 263 milionë euro.

D. Kërkesa për aktvendim

213. Mbështetur në provat e administruara dhe në argumentet e paraqitura në këtë padi dhe propozim, dhe duke u thirrur në nenin 306.1 të Ligjit për procedurën kontestimore, paditëse-propozuesja e lut Gjykatën e nderuar të nxjerrë *menjëherë* këtë:

AKTVENDIM

- I. **Miratohet** si e themeltë kërkesa e paditëse-propozueses Federata Sindikale e Pavarur e PTK-së për masa të sigurimit ndaj të paditur-kundërpropozuesit DARDAFON.net L.L.C.
- II. **I ndalohet** të paditur-kundërpropozuesit:
 - (A) të vazhdojë Marrëveshjen e mbështetjes e operatorit të rrjetit mobil virtual, lidhur me ndërmarrjen publike Telekomi i Kosovës, SH.A., më 16 janar 2009, dhe përfunduar më 30 korrik 2019;
 - (B) të negociojnë për të lidhur kontratë tjetër për rrjet virtual të telefonisë mobile; dhe
 - (C) të zbatojnë çfarëdo kontrate që mund të kenë lidhur gjatë kohës mes përpilimit të kërkesës së paditës-propozueses dhe shqyrtimit të saj.
- III. **I ndalohet** të paditur-kundërpropozuesit DARDAFON.net L.L.C. të tjetërsojë, të fshehë, të ngarkojë ose të disponojë me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme me vlerë deri në 264.000.000,00 euro.

159 Shih pjesën VI.B të kësaj padie.

- IV. **I ndalohet** të paditur-kundërpropozuesit DARDAFON.net L.L.C. që në cilësinë e kreditorit të kërkojë ose të pranojë nga ndërmarrja publike Telekom i Kosovës, SH.A., ose nga aksionari i saj:
- (A) përmbushjen e detyrimeve nga Vendimi final i arbitrazhit i 9 dhjetorit 2016, nxjerrë për rastin 20990/MHM pranë tribunalit të Odës Ekonomike Ndërkombëtare (ICC); dhe
 - (B) përmbushjen e detyrimeve të tjera që mund të caktohen sipas Marrëveshjes së mbështetjes e operatorit të rrjetit mobil virtual, lidhur me ndërmarrjen publike Telekom i Kosovës, SH.A., më 16 janar 2009.
- V. **Detyrohet** i paditur-kundërpropozuesi të pezullojnë të gjitha veprimet që kanë nisur në kundërshtim me këtë aktvendim.
- VI. Ky aktvendim mbetet në fuqi deri në një vendim të ri të Gjykatës.

VIII. KËRKESËPADIA

214. Padiësja Sindikata e punëtorëve të Telekomit po i kërkon Gjykatës të konstatojë nulitetin e Marrëveshjes mes Telekomit e Z Mobiles për rrjetin e operatorit virtual. Neni 89 LMD quan të pavlefshme kontratën që cenon rendin publik, dispozitat urdhëruese dhe moralin e shoqërisë. Marrëveshja e goditur shkel parimet e normat kushtetuese, bie ndesh dispozitat e LMD-së dhe dërrmon telekomunikacionin në vend.
215. Rrjedhimisht, mbështetur në provat e administruara dhe në argumentet e paraqitura në këtë padi, dhe duke u thirrur në nenet 142.3 dhe 143.1 LPK, padiësja e lut Gjykatën e nderuar të nxjerrë këtë:

AKTGJYKIM

- I. **Miratohen** në tërësi si **të themelta** padia dhe kërkesëpadija e padiësës Federata Sindikale e Pavarur e PTK-së ndaj të paditurit DARDAFON.net L.L.C.
- II. **Vërtetohet** se Marrëveshja e mbështetjes e operatorit të rrjetit mobil virtual, lidhur mes të paditurit dhe ndërmarrjes publike Telekomit i Kosovës, SH.A., më 16 janar 2009, është e pavlefshme që nga data e nënshkrimit të saj.
- III. **Detyrohet** i padituri që, brenda 15 ditësh, t'ua paguajë padiësës Federata Sindikale e Pavarur e PTK-së dhe ndërmarrjes publike Telekomit i Kosovës, SH.A., shpërblimet e dëmit në lartësitë e caktuara nga eksperti gjyqësor dhe kamatën prej 8 për qind.
- IV. **Detyrohet** i padituri t'ia paguajë padiësës brenda 15 ditëve shpenzimet e përfaqësimit dhe të gjyqit.

Përfaqësuesit e padiësës:

Dr. Getoar Mjeku, jur.

Blerim Sallahu, jur.